

Shkurt 2023
Numri: 179
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA



**MOS LEJONI QË JETA E KËSAJ BOTE
T'JU MASHTROJË!**



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Shkurt 2023

VITI: XVII

NUMRI: 179

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

PËRKTHYES

Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIETOR

Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”
(Hashr, 19)

Shitje e fesë do të thotë të harrosh Allahun dhe për rrjedhojë dënohet me harrim të vetes. Ata që e meritojnë këtë dënim shpesh nuk janë të vetëdijshëm se në çfarë lloj mashtrimi janë. Psikologjinë e kësaj blerjeje e përcakton pasioni dhe entuziazmi; sociologjinë e saj e përcakton kolltuku, pozita, statusi dhe klasa dhe ekonominë e saj e përcakton zgjedhja e stilit të jetesës.

Akabe është një fjalë arabe që do të thotë kalim i thepisur dhe i ngushtë. Në gjeografinë arabe ka shumë lugina me këtë emër. Por kur thuhet Akabe, së pari kuptohet lugina afër Xhemaratit, tri kilometra larg Mekës, ku shejtani gjuhet me gurë. Ky është vendi ku i Dërguari i Allahut (a.s.), e mori fjalën në emër të Allahut fillimisht nga dy mbëdhjetë e më pas shtatëdhjetë e pesë njerëz nga Medina. Premtimi që banorët e Medinës i bënë Allahut në këtë vendkalim të ngushtë mes dy maleve ka një natyrë madhështore që përcakton kornizën e marrëdhënies së çdo besimtari me Allahun deri në Ditën e Gjykimit, në këtë kalim të thepisur të quajtur “botë-dynja”.

Kjo botë është akabeja jonë. Akabe është një treg në të cilin shiten jeta dhe pasuria. Zoti (xh.xh.), na ka kërkuar jetën dhe pasurinë tonë në këtë treg dhe në këmbim na ka premtuar lumturi të përjetshme. Kjo është në fakt shprehja në tokë e premtimit që i bëmë Zotit në Elest Bezmi (pafillimësi). Në këtë kontekst, Akabe është miniatura në sipërfaqen e kësaj toke e asamblesë së besëlidhjes sonë në botën shpirtërore. Është mishërimi i marrëveshjes që kemi bërë me Zotin (xh.xh.), në kuadër të shembujve më të bukur të shpalosur nga Njeriu më i Mirë (i Dërguari i Allahut a.s.).


Shitja e fesë nga ana e njeriut fillon me një orientim psikologjik. Së pari ndryshon qëllimi (nijeti). Pastaj perceptimi... Çdo shitje ka një proces bindjeje. Edhe në shitjen e besëlidhjes me Allahun, sigurisht që ka një arsyetim të përzier me teka. Më pas kërkohen perceptime të afërta. Ata që nuk duan të jenë vetëm në vendin që kanë zgjedhur, gjejnë miqtë e tyre të pasionit. Ky është socializim. Socializimi e imponon njeriun me një mënyrë jetese që përcakton gjithashtu edhe ekonominë e tij me kalimin e kohës. Ata që e shesin besëlidhjen me Allahun (xh.xh.), në këtë mënyrë, në të vërtetë fillojnë të shkojnë drejt fundit të tyre në rrjedhën e një stili jetese, të menduari dhe rrjedhimisht një gjendje shpirtërore që e kanë blerë.

Përmbajtja



8

Ajetet e Allahut
dhe gjendjet e zemrës
Dr. Adem Ergyl



"Ai e shet fenë
për një interes të thjeshtë"
Dr. A. Hamdi Jëlldërem

18



12

26



Imam Ahmed ibn Hambel (r.a.)
Osman Nuri Topbash

- 5 Mos e shisni fenë tuaj
Mehmet Lutfi Arslan
- 10 Llojet e shitjes së fesë
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Fundi i atij që shet besëlidhjen
është poshtërim
Prof. dr. Halis Ajdemir
- 20 Kush janë robërit
e veçantë të Allahut
Omer Çelik
- 22 Drita e mendjes dhe drita e zemrës
Ali Riza Temel
- 24 Një dijetar me zemër
të zbrazet nga çdo shqetësim
Ajden Bashar



36

Moda jonë e të gjitha kohërave është 36
Kurani dhe Suneti
Kubra Çoban

Jetimi im, i mjeri im... 39
Ajshenur Vurall

Një zonjë prej banorëve të xhenetit 40
Adem Saraç

32

Kjo pajisje
do ta ndryshojë botën
Dr. Mustafa Mahmud



MOS E SHISNI FENË TUAJ

— Mehmet Lutfi Arsllan —

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (Hashr, 19)

Shitje e fesë do të thotë të harrosh Allahun dhe për rrjedhojë dënohet me harrim të vetes. Ata që e meritojnë këtë dënim shpesh nuk janë të vetëdijshëm se në çfarë lloj mashtrimi janë. Psikologjinë e kësaj blerjeje e përcakton pasioni dhe entuziazmi; sociologjinë e saj e përcakton kolltuku, pozita, statusi dhe klasa dhe ekonominë e saj e përcakton zgjedhja e stilit të jetesës.

Akabe është një fjalë arabe që do të thotë kalim i thepisur dhe i ngushtë. Në gjeografinë arabe ka shumë lugina me këtë emër. Por kur thuhet Akabe, së pari kuptohet lugina afër Xhemaratit, tri kilometra larg Mekës, ku shejtani gjuhet me gurë. Ky është vendi ku i Dërguari i Allahut (a.s.), e mori fjalën në emër të Allahut fillimisht nga dymbëdhjetë e më pas shtatëdhjetë e pesë njerëz nga Medina. Premtimi që banorët e Medinës i bënë Allahut në këtë vendkalim të ngushtë mes dy maleve ka një natyrë madhësh-

tore që përcakton kornizën e marrëdhënies së çdo besimtari me Allahun deri në Ditën e Gjykimit, në këtë kalim të thepisur të quajtur “botë-dynja”.

Kjo botë është akabeja jonë. Akabe është një treg në të cilin shiten jeta dhe pasuria. Zoti (xh.xh.), na ka kërkuar jetën dhe pasurinë tonë në këtë treg dhe në këmbim na ka premtuar lumturi të përjetshme. Kjo është në fakt shprehja në tokë e premtimit që i bëmë Zotit në Elest Bezmi (pafillimësi). Në këtë kontekst, Akabe është miniatura në sipërfaqen e kësaj toke e asamblesë së besëlidhjes sonë në botën shpirtërore. Është mishërimi i marrëveshjes që kemi bërë me Zotin (xh.xh.), në kuadër të shembujve më të bukur të shpalosur nga Njeriu më i Mirë (i Dërguari i Allahut a.s.).

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Allahut dhe besimtarëve në Akabe ka një natyrë që i përfshin të gjithë besimtarët deri në ditën e llogarisë. Rëndësia e kësaj kontrate qëndron në vlerësimin se cili është kriteri i vlerës. Çfarë mund të blihet dhe shitet në tregun e kësaj bote dhe cili është çmimi i tyre është bërë i qartë në Akabe. Atë ditë, Zoti (xh.xh.), nëpërmjet të Dërguarit të Allahut (a.s.), mori jetën dhe pasurinë tonë dhe në këmbim premtoi jetë të



përjetshme. Tashmë, se çfarë është objekti i blerjes dhe shitjes, për më tepër çmimi, është e qartë: **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.”** (Teube, 111)

Gjykimi i vlerës që u shfaq në tregun e Akabesë është e vërteta se çmimi i atyre që posedon njeriu është vetëm dhe vetëm jeta e përhershme. Çdo shitje që bëhet përveç kësaj është një humbje, është një dëm, sepse kriteri i vlerës në tregun e Akabesë është një masë e përjetuar dhe e provuar. Besimtarët, veçanërisht ensarët, të cilët ishin të vetëdijshëm për premtimin që i kishin dhënë Allahut atë ditë, na e kanë treguar realitetin e kësaj marrëveshjeje me përvojat e tyre. Es’ad ibn Zurare, radijall-llahu anh, i cili ishte njëri prej tyre, tha atë ditë: «O I Dërguari i Allahut! Ne do të të mbrojmë ty siç mbrojmë veten, fëmijët dhe gratë tona. Nëse e thyejmë këtë besëlidhje, le të jemi njerëz fatkeq që kemi thyer besëlidhjen me Allahun! O i Dërguar i Allahut! Ky është betimi ynë për besnikëri ndaj Teje! Vetëm Allahu Teala është Ai te ndihma e të Cilit mund të strehohemi!» Kjo fjalë ishte vendosja e emrit të marrëveshjes së njeriut të bërë me Allahun nga dikush i shëndoshë mendërisht që e dinte se çfarë dhe pse po blinte.

Abdullah ibn Ravaha (r.a.), i cili e mori fjalën pas Es’adit (r.a.), gjithashtu deklaroi se i Dërguari i Allahut mund t’i vendoste çdo kusht që dëshironte për Zotin e tij dhe për veten e tij, me besimin dhe qetësinë shpirtërore të shitblerjes që kishte bërë. Pas kësaj, Profeti (a.s.), ia ktheu: **“Kushti im për Zotin është që ta adhuronit Atë dhe të mos i bëni shok Atij. Kushti për veten time është që të më mbronit ashtu siç mbronit jetën dhe pasurinë tuaj.”** Që nga ajo ditë, sahabët e nderuar, të cilët do të quheshin ensarë, pyetën se çfarë do të merrnin në këmbim nëse do të vepronin kështu. Kur Pejgamberi (a.s.), u tha: **«Do të keni xhenetin!»**, ata që ndodheshin aty e shprehën kënaqësinë e tyre duke thënë: **“Çfarë tregtie fitimprurëse! Ne nuk kthehem nga kjo, as nuk duam të kthehem!”**

Jeta e mëvonshme e ensarëve është argument se ata nuk i thyen premtimet që dhanë. Atë ditë, një e treta e atyre që i kapën dorën të Dërguarit të Allahut në Akabe sakrifikuuan jetën e tyre në rrugë të Allahut duke vdekur si dëshmorë. Duke shfaqur ndaj muhaxhirëve që shkuan në qytetin e tyre një shembull të sakrificës që nuk ishte parë kurrë në historinë njerëzore, ata ndanë gjithë pasurinë e tyre

me kënaqësi të përzemërt. Premtimin që ia bënë Allahut në Akabe, nuk e thyen për asnjë interes, pozitë, përfitim apo çmim të kësaj bote. Ai që morën në këmbim të jetës dhe pasurisë së tyre ishte xheneti. Ata kurrë nuk e ulën masën e vlerës dhe gjithmonë e mbajtën besëlidhjen me Zotin (xh.xh.). Fjalët amanet të Sa’d ibn Rebiut (r.a.), i cili ishte njëri prej tyre, kur ra dëshmor në Uhud, ishin manifestim i kësaj besnikërie që i dridh zemrat:

Pasi politeistët kurejshë u larguan nga mejdani i Uhudit, i Dërguari i Allahut (a.s.), pyeti se në çfarë gjendjeje ishte Sa’d ibn Rebiu. **«Atë e pashë një herë atje.»**, tha ai (a.s.), duke treguar nga njëra anë. Një burrë nga ensarët e mori përsipër detyrën dhe shkoi në drejtimin e treguar. Ai nuk e pa Sa’din ndër dëshmorët e shtrirë në luginë. Pastaj thirri: **“O Sad, i Dërguari i Allahut më dërgoi te ti.”** Vetëm pas kësaj u dëgjua një rënkim nga Sa’di, radijall-llahu anh. Kur burri që shkoi te Sadi i tha: **“I Dërguari i Allahut më ka urdhëruar ta informoj nëse je gjallë apo i vdekur.”**, Sa’di i tha: **“Tani jam në mesin e të vdekurve. Mund të nuhas aromën e xhenetit. Dërgoji përshëndetjet e mia të Dërguarit të Allahut dhe i thuaj: “Allahu të shpërbleftë», thotë Sa’d ibn Rebiu. Çoji përshëndetjet e mia edhe popullit tim Ensar! Le të mos e harrojnë besëlidhjen e tyre me të Dërguarin e Allahut në natën e Akabesë. Përderisa sytë të shikojnë dhe qerpikët të lëvizin, nëse nuk e mbronin mirë Pejgamberin dhe bëheni shkak që t’i ndodhë ndonjë dëm, nuk ka asnjë justifikim që mund ta shfaqni në audiencën e Allahut.»** (Muvatta, Xhihad, 41.)

Çmimi i tregtisë që bëhet me Allahun është i qartë. Besimtarët, nëse mund ta shprehim me një thënie moderne, e kanë “blerë” këtë vlerë, domethënë, që nga Profeti (a.s.) e deri në kohët e sotme, ata e kanë formësuar jetën e tyre sipas kësaj norme dhe nuk kanë pranuar çmime të tjera. Duke e ditur se kjo normë është e paçmueshme në këtë botë, ata aspiruan jo gjërat e kufizuara dhe të fundme të kësaj bote, por gjërat e pafundme dhe të pashtershme që gjenden te Allahu (xh.xh.). Të gjithë besimtarët duke filluar që nga miqtë e të Dërguarit të Allahut, të cilët preferuan ezanin e Horasanit në vend të



Medinës, e deri te të parët tanë, të cilët nuk hezitan të jepnin jetën për hir të Allahut, fesë, atdheut dhe gjërave të shenjta, i transferuan deri në ditët e sotme mbajtjen e premtimit ndaj Allahut (xh.xh.) dhe mosshitjen e fesë së tyre të pastër për asgjë përveç çmimit të saj si një frymë e Akabesë.

Situata nuk është ndryshe as sot. Feja është e qartë, çmimi është i qartë. Tregu i kësaj bote është një treg ku secili ofron veten e tij dhe përfundimisht pranon një çmim në një mënyrë ose në një tjetër. Këtu të gjithë e nxjerrim veten në shitje çdo ditë. I Dërguari i Allahut (a.s.), na thotë se kjo është kështu: *“Çdo njeri ngrihet çdo mëngjes dhe e ofron shpirtin e tij për shitje. Disa e çlirojnë atë dhe disa e shkatërrojnë.”* (Muslim, Tahare, 1.) Të vërtetën që tregon për secilin se çfarë çmimi pranon, e nxjerr në pah përkushtimi dhe vepra e tij që ka bërë për atë çmim. Besimtari është njeriu që e cakton çmimin e vet sipas çmimit të caktuar nga Allahu (xh.xh.). Ai çmim në Akabe është përcaktuar si xheneti në këmbim të pasurisë dhe jetës.

Përveç këtij çmimi, çdo çmim tjetër për të cilin bihet dakord, i përket kësaj bote. Çdo çmim që i përket kësaj bote është i numëruar, i kufizuar. Prandaj, është një humbje, është dëm. Ata që kënaqen me vlerat e përkohshme e kanë shitur besëlidhjen me Allahun. Kjo do të thotë shitje e fesë.

Ata që i shesin besëlidhjet e tyre me Allahun me çmime të ulëta edhe pse vlera e tyre është e caktuar, janë ata që e ulin vlerën e shpirtit të tyre në nivelin e dynjasë. Atij që nuk ia di vlerën vetes, nuk do t’ia dijë vlerën askush. Dënimi më i madh që mund t’i jepet një njeriu në këtë botë është të pranojë këtë pavlefshmëri. Në të vërtetë, Allahu i ka dënuar ata që e harrojnë veten dhe besëlidhjen e tyre duke i bërë të harrojnë vetveten: *“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun dhe Allahu i bëri ata të harrojnë veten e tyre, ata janë të devijuarit.”* (Hashr, 19) Të shesësh fenë do të thotë të harrosh Allahun. Rrjedhimisht kjo ndëshkohet me harresë të vetes. Ata që e meritojnë këtë dënim shpesh herë nuk janë të vetëdijshëm se në çfarë lloj mashtrimi gjenden. Sepse kushtet psikologjike, sociologjike dhe materiale të shitjes së fesë, si trillime të nxitura dhe të përgatitura nga një qëllim dhe orientim, nuk e tregojnë këtë mashtrim si mashtrim. Secili ka një çmim në tregun e kësaj bote dhe secili e ka blerë pozicionin e tij. Psikologjinë e kësaj blerjeje e përcakton pasioni dhe entuziazmi; sociologjinë e saj e përcakton kolltuku, pozita, statusi dhe klasa dhe ekonominë e saj e përcakton zgjedhja e stilit të jetesës.

Shitja e fesë nga ana e njeriut fillon me një orien-



tim psikologjik. Së pari ndryshon qëllimi (nijeti). Pastaj perceptimi... Çdo shitje ka një proces bindjeje. Edhe në shitjen e besëlidhjes me Allahun, sigurisht që ka një arsyetim të përzier me teka. Më pas kërkohen perceptime të afërta. Ata që nuk duan të jenë vetëm në vendin që kanë zgjedhur, gjejnë miqtë e tyre të pasionit. Ky është socializim. Socializimi e imponon njeriun me një mënyrë jetese që përcakton gjithashtu edhe ekonominë e tij me kalimin e kohës. Ata që e shesin besëlidhjen me Allahun (xh.xh.), në këtë mënyrë, në të vërtetë fillojnë të shkojnë drejt fundit të tyre në rrjedhën e një stili jetese, të menduari dhe rrjedhimisht një gjendje shpirtërore që e kanë blerë.

A nuk përjetojnë të njëjtën përvojë edhe besimtarët që e kanë blerë besëlidhjen me Allahun (xh.xh.)? Procesi nuk është i ndryshëm. Dallimi është se me çfarë disponimi dhe motivi dhe me kë zgjedhim të jemi, dhe më e rëndësishmja, kujt i drejtohem mes shitësve që na kërkojnë për të na blerë. Sepse të gjithëve u jepet ajo që dëshirojnë dhe përsëri të gjithëve u lehtësohet rruga në të cilën ecin: ***“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë që t’i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiket për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet. Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt.”*** (Isra, 18-20)

Po, bujaria e Zotit (xh.xh.), nuk është e kufizuar. Secilit do t’i jepet ajo që dëshiron. Secilit do t’i jepet mundësia që t’ia shesë veten kujt të dëshirojë. Kush, në këmbim të çfarë gjëje, me çfarë çmimi është i gatshëm të pranojë? Ata që dëshirojnë të shfaqin këmbëngulje në besëlidhjen me Allahun (xh.xh.), të mos e shesin fenë e Allahut dhe për rrjedhojë të zgjedhin çmimin më të përshtatshëm për shpirtin e tyre, duhet të jenë ndër të devotshmit dhe të sinqertët që e kanë bërë këtë synim ëndërr të tyre dhe duhet ta vendosin përpjekjen për të jetuar si mysliman në krye të të gjitha përpjekjeve. Përndryshe, ata që e kuptojnë, e dinë se tregu është shumë i keq.



AJETET E ALLAHUT dhe gjendjet e zemrës

— Dr. Adem Ergyl —

Ajetet e të Gjithëmëshirshmit janë për të lartësuar njeriun, jo për ta ulur atë. Mirëpo, kushdo që nuk u qaset ajeteve me besim dhe respekt, dhe në vend që të kapet pas tyre për t'u lartësuar, i merr ato si një shkallë për arritjen e qëllimeve të tij të ulëta, ja pra, këta njerëz do ta shijojnë mjerimin dhe poshtërimin derisa janë ende në këtë botë.

Gjendjet njerëzore janë të ndryshme përballë fjalës së Zotit. Ky dallim është i drejtpërdrejtë në përpjesëtim me qëndrimin e zemrave ndaj fjalës hyjnore. Ndërsa ajetet hyjnore tregojnë efektin e shërimit, udhëzimit dhe mëshirës për disa, të njëjtat ajete mund të shkaktojnë errësirë të zemrës, zhgënjim, hutim dhe madje edhe devijim për disa të tjerë. Sekretin përcaktues këtu është synimi, ndjenja dhe orientimi i zemrës drejt fjalës hyjnore. Me fjalë të tjera, shkalla e besimit në fjalën e Zotit apo një pikëpamje skeptike dhe mohuese përcaktojnë rezultatin. Në ajetin e 7-të të sures Al Imran, vëmendja tërhiqet te kjo e vërtetë si më poshtë:

«Është Ai që të ka shpallur ty (Muhamed) Librin, disa vargje të të cilit janë të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë (muhkem). Ato janë themelet e Librit. Kurse disa (vargje) të tjera janë jo krejtësisht të qarta Muteshabih¹ (me kuptime alegori-

1. Muhkem është ajeti, “kuptimi dhe domethënia e të cilit kuptohet qartë, qoftë në vetvete apo kur merren parasysh shprehjet e tjera”; kurse muteshabih është ajeti, “kuptimi dhe argumentimi i të cilit nuk mund të kuptohet qartë, as në vetvete, as kur merren parasysh shprehjet e tjera”, pra, ka kuptim alegorik.

ke). Ata, zemrat e të cilëve priren nga e pavërteta, ndjekin vargjet më pak të qarta, duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dijeni, thonë: “Ne i besojmë (Kuranit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët. (Al Imran, 7)

Çështja kryesore e theksuar në këtë ajet është dallimi në qëndrim midis atyre që kanë shtrembërim në zemrat e tyre dhe atyre që janë të rrënjosur thellë në dije kundrejt ajeteve të Allahut (xh.xh.). Dijetarët e vërtetë, të cilët janë të rrënjosur thellë në dije, para së gjithash, kanë besuar se të gjitha ajetet e zbritura janë nga Allahu Teala, domethënë, ata e kanë miratuar dhe pranuar të vërtetën e ajeteve në zemrat e tyre. Nga ana tjetër, ata që kanë shtrembërim në zemrat e tyre, ndjekin vargjet që mund të kenë më shumë se një kuptim dhe synojnë të krijojnë një atmosferë trazirash (fitne). Aty është vënë në dukje se të jesh në gjendje ta kuptosh këtë pikë të ndjeshme, të kthehesh në drejtimin e duhur duke marrë këshilla prej saj dhe të qëndrosh në rrugën e drejtë, duhet të jesh “ulu'l-elbab”. «Ulu'l-elbab» do të thotë të kesh aftësinë e arsyetimit të udhëhequr nga besimi. Ja çfarë kuptohet prej kësaj:

Sa më shumë dobësi në besim, aq më shumë bëhet e vështirë të kuptosh shenjat në ajete, madje lindin edhe kuptime të gabuara. Në fakt, nganjëherë

dalin në pah kuptime të tilla, saqë ajetet të cilat janë mjet udhëzues, e shtojnë devijimin për shkak të prishjes-shtrembërimit në zemra.

Nga ana tjetër, ajeti i 8-të i sures Al Imran, në një formë shumë më interesante, thotë se dijetarët e vërtetë janë të vetëdijshëm për këtë sekret dhe i bëjnë lutjen e mëposhtme Zotit të Madhëruar:

«(Ata thonë:) **“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen** (nga e vërteta), **pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!**» (Al Imran, 8)

Kurani Fisnik është një libër i shenjtë që duhet trajtuar me mirësjellje dhe respekt të lartë ngaqë është fjala e Zotit (xh.xh.). Ata që duan të kenë një takim të shëndetshëm me ajetet e Kuranit, fillimisht duhet të korrigojnë qëllimet në zemrat e tyre. Andaj nuk duhet të bëjnë gabim duke e parë atë si një fjalë të zakonshme njerëzore.

Kadir Misiroglu tregon:

«Unë kam njohur shumë dijetarë dhe hoxhallarë që kanë marrë begatinë e osmaneve. Reisu'l-Kurra Abdurrahman Gyrses Hoxha Efendi ishte personi që unë e admiroja më shumë ndërmjet tyre. Ai ishte një dijetar dinjitoz. Andaj dëshiroj të ndaj me ju një kujtim:

Ischim në një kuvend ligjërata fetare në shtëpinë e Musa Topbash Efendiut, një prej shehlerëve të periudhës së fundit. U kërkua që ligjërata fetare të fillonte me leximin e Kuranit Fisnik. Abdurrahman Gyrses hoxha sapo kishte kënduar istiadhen dhe besmelenë, kur në atë moment një nga të pranishmit shkoi te hoxha, u përkul te veshi i tij dhe i tha:

«Hoxhë, a mund ta mbani pak shkurt, sepse pas jush do të ketë një fjalim Mjeshtri Nexhip Fazëlli.»

Nisur nga kjo, Abdurrahman hoxha e përfundoi menjëherë këndimin duke thënë: «Sadakall-llahu'l-Adhim!»

Atyre që shprehën habi duke i thënë: «Çfarë ndodhi, hoxhë, nuk kënduat asgjë!», hoxha i nderuar iu përgjigj me dinjitet të madh siç vijon:

«Unë nuk këndoj pjesë nga Kurani Fisnik në një vend ku fjala e robit preferohet ndaj fjalës së Allahut!»

Zoti (xh.xh.), deklaroi se e ka zbritur Kuranin Fisnik si një udhërrëfyes që tregon rrugën e drejtë, si një burim mëshire që e shndërron njeriun në personalitet të frytshëm, si një shërim shpirtëror për sëmundjet e zemrës, si një dritë hyjnore që ndriçon errësirën e mohimit dhe dyshimit, si një përkujtues të madh (dhikër) që ua kujton të vërtetat mendjes dhe ndërgjegjes dhe si një burim (besair) që hap dhe ushqen largpamësinë dhe vizionin. Për këtë arsye, zemrat besimtare që dëshirojnë të takohen me Kuranin Fisnik, duhet t'i qasen atij vetëm me

qëllime kaq të pastra, pastaj duhet të takohen me të, të formojnë miqësi me të dhe në fund të përfitojnë prej tij.

Pas besimit në ajetet e Zotit (xh.xh.), detyra e besimtarit duhet të jetë përpjekja për t'i kuptuar ato drejt dhe për t'i zbatuar në jetë. Vullneti i Zotit (xh.xh.), do të jetë e mundur të kuptohet aq sa masa e drejtimit të pastër (mutahhar) në botën tonë shpirtërore. Ata që kërkojnë udhëzim do të gjejnë udhëzim, ata që kërkojnë mëshirë do të arrijnë mëshirën dhe ata që duan të dalin nga errësira do të gjejnë një rrugëdalje.

Ajetet e të Gjithëmëshirshmit janë për të lartësuar njeriun, jo për ta ulur atë. Mirëpo, kushdo që nuk u qaset ajeteve me besim dhe respekt, dhe në vend që të kapet pas tyre për t'u lartësuar, i merr ato si një shkallë për arritjen e qëllimeve të tij të ulëta, ja pra, këta njerëz do ta shijojnë mjerimin dhe poshtërimin derisa janë ende në këtë botë.

Në Kuranin Fisnik tregohet si më poshtë edhe shembulli i të tillëve:²

«Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), **por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.»** (A'raf, 175-176)

Një nga urtësitë e urdhrit: **«Kur të lexosh Kuran, kërko strehim tek Allahu nga shejtani i dëbuar nga mëshira.»** (Nahl, 98), është se disa mashtime dhe sugjerime plot dyshime që dalin nga shejtanët njerëz dhe xhindë mund të përbëjnë pengesë për afrimin ndaj Kuranit me një zemër krejt të pastër. Meqenëse është jashtëzakonisht e vështirë të qëndrosh larg pikëpamjeve dhe sugjerimeve të tilla në këtë epokë komunikimi që jetojmë, ne kemi përgjegjësinë të kërkojmë më shumë strehim në mbrojtjen e Zotit (xh.xh.). Për këtë arsye, duhet të strehohemi tek Allahu duke thënë (istiadhen): **«Eudhu bi'l-lahi minesh-shejtani'rr-raxhim»** në çdo kontakt që do të kemi me Kuranin dhe duke thënë: **«Bismi'l-lahi'rr-Rrahmani'rr-Rrahim.»**, duhet t'i kërkojmë ndihmë Atij (istiane).

2. Për personin e dhënë si shembull janë dhënë mendime të ndryshme. Shumica e komentuesve të Kuranit janë shprehur se ky person ishte një dijetar hebre me emrin Bel'am b. Baura.

LLOJET e shitjes së fesë



Siç ka thënë Zoti (xh.xh.), ata që dëshirojnë mund të besojnë dhe ata që nuk dëshirojnë mund të mos besojnë, por rregullat e fesë nuk mund të ndryshohen për kënaqësinë e atyre që nuk besojnë.

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Siç ka thënë Zoti (xh.xh.), ai që dëshiron mund të besojë dhe ai që nuk dëshiron mund të mos besojë, por rregullat e fesë nuk mund të ndryshohen për kënaqësinë e atyre që nuk besojnë. Abd do të thotë rob, pra, ai që i bindet vullnetit të Zotit të tij. Kushdo që është rob i Allahut e lë vullnetin e vet dhe i bindet vullnetit të Zotit (xh.xh.).

Allahu Teala na ka dërguar në këtë botë për të na sprovuar dhe ka dashur që me besim dhe vepra të mira përsëri të bëhemi të denjë për xhenetin. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në një hadith se «*kjo botë është ara e botës së përtejme*». Kjo botë bëhet e vlefshme vetëm kur shndërrohet në një shkallë nëpërmjet të cilës mund të ngjitemi në botën tjetër. Myslimani i devotshëm i mobilizon të gjitha burimet e tij për fenë e vet dhe e shpenzon jetën e pasurinë e tij për të arritur xhenetin dhe Xhemalullahun (bukurinë e Allahut). Mirëpo, në këtë botë që kemi ardhur për t'u sprovuar, ndonjëherë ndodh e kundërta, disa njerëz të pavëmendshëm, madje edhe tradhtarë, përpiqen ta ndërtojnë botën e tyre duke shitur fenë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka shpjeguar dëmin që njerëzit e tillë i shkaktojnë fesë me hadithin e mëposhtëm:

“Dëmi që i shkaktojnë tufës së deleve dy ujqër të uritur që zhyten në kope, absolutisht nuk është më i rëndë se dëmi që i shkakton fesë ambicia e një njeriu për të fituar pasuri dhe pozitë (pasuri dhe famë).” (Tirmidhi, Zuhd, 43.)

Nëse këta ujqër të uritur kërkojnë veçanërisht të bëhen njerëz të ditur dhe burra shteti, dëmi i tyre ndaj fesë shtohet shumëfish, sepse këto dy grupe kanë më shumë mundësi të përpiqen t'i ndryshojnë dispozitat hyjnore, t'i bëjnë të harrohen nga njerëzit dhe t'i banalizojnë ato. Ata që e bëjnë këtë veprim të mallkuar me vetëdije dhe dëshirë, Allahu na ruajt, janë të dalë nga feja. Krahas këtyre, edhe

klerikët që fshehin dispozitat hyjnore për përfitimin e tyre nuk mund të shpëtojnë nga një dënim i madh. Imam Rabbani u angazhua në një luftë të pamëshirshme me të dyja këto grupe në jetën e tij, luftoi me Shahun Ekber dhe «dijetarët e sarajit» të tij, të cilët tentuan për të ndryshuar fenë dhe kaloi kohë në burg për shkak të kësaj çështjeje. Ndërsa ai bënte atë që kërkonte dija dhe mbronte Islamin, disa ujqër të uritur të maskuar si dijetarë, mbështetën fenë e sajuar të quajtur «feja hyjnore» me fetva të rreme që lëshonin. Në ditët e sotme gjithashtu disa qarqe po përpiqen të shpikin një tjetër «fe hyjnore» në mënyrën e tyre. Sipas kësaj turme të çoroditur, që i përket kësaj feje të sajuar, e cila nuk ka sheriat, kufijtë e haramit dhe hallallit të saj janë jashtëzakonisht të gjerë dhe çdo gjë e saj është e lejuar, shumica e dispozitave të Islamit janë historike, domethënë, rregullat e Islamit në çështjet si kamata, mbulesa, martesë, divorci dhe trashëgimia vlejnë vetëm për atë kohë. Sipas tyre, ne sot mund të bëjmë dispozita sipas qejfit tonë për këto çështje!

Imam Rabbani i paralajmëron njohësit e dijes, pra teologët dhe akademikët e sotëm, misioni i të cilëve është t'i shërbejnë zbatimit sa më të mirë të Islamit, siç vijon: “Dhënia e ligjëratave dhe fetvave bëhet vetëm për Allahun (xh.xh.). Këto bëhen të dobishme nëse mbahen larg joshjes së autoritetit, pozitës, pasurisë dhe epërsisë. Shenja e kësaj është të kesh asketizëm, pra të mos shfaqësh interes për këtë botë. Dijetarët që janë kapluar nga dashuria e kësaj bote janë “dijetarë të interesit”. Ata në të njëjtën kohë janë dijetarë të këqij, më të ligët e njerëzve dhe hajdutë të fesë. Megjithatë, ata e konsiderojnë veten prijës të fesë dhe më të lartët e njerëzve...” (Vëll. 1, Letra e 33-të.)

Imam Rabbani i konsideron si hajdutë të fesë

njuhësit e dijës që e shesin fenë tonë të bukur për shkak të dashurisë ndaj gradave, pozitës dhe famës. Hajdutët më të këqij janë njerëzit që i mashtrojnë brezat e ardhshëm duke vjedhur nga feja dhe që përpiqen ta shkatërrojnë fenë.

Sipas Imamit, tregtarët e tillë të fesë janë ortakë të shejtanit.

Ajeti i mëposhtëm e deklaroi qartë këtë: **«Ata i ka marrë nën ndikim shejtani dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e shejtanit; në të vërtetë, pala e shejtanit janë humbësit.»** (Muxhadile, 19)

Imam Rabbani e shpjegon partneritetin e tipave të tillë të çoroditur me shejtanin në shkatërrimin e Islamit siç vijon: “Një nga të mëdhenjtë e pa shejtanin duke qëndruar ulur anash larg shqetësimit për të mashtruar njerëzit. Atë e pyeti se pse ishte ulur kaq indiferent. Djalli i mallkuar iu përgjigj duke i thënë: Dijetarët e këqij të kohës më kanë siguruar shumë mbështetje në punën time. Ata kanë marrë përsipër t’i mashtrojnë njerëzit në vendin tim. Andaj po rri indiferent ndaj punës sime!” Në të vërtetë, çdo dobësi që lind në çështjet e sheriatit dhe çdo defekt në bërjen e umetit islam superior; gjithmonë ka ndodhur për shkak të pafrytshmërisë të dijetarëve të këqij dhe qëllimeve të tyre të prishura.

Siç ka thënë Zoti (xh.xh.), ata që dëshirojnë mund të besojnë dhe ata që nuk dëshirojnë mund të mos besojnë, por rregullat e fesë nuk mund të ndryshohen për kënaqësinë e atyre që nuk besojnë.

Abd do të thotë rob, pra, ai që i bindet vullnetit të Zotit të tij. Kushdo që është rob i Allahut, e lë vullnetin e tij dhe i bindet vullnetit të Zotit. Mevlana i krahason robërit e tillë të sinqertë me një komandant fortëse heroike që shërben si ushtar në pikën më të largët të perandorisë së sulltanit. Ky komandant hero e refuzon çdo ofertë ryshfeti që i vjen nga armiku. Ndërsa është e mundur ta shesë kështjellën, të bëhet i pasur dhe të shpëtojë jetën e tij, komandanti besnik bën të kundërtën, jep jetën dhe nuk ia dorëzon kështjellën armikut.

Një mënyrë tjetër e shitjes së fesë është të injorohet rregullat e fesë kur ato nuk u përshtaten interesave tona. Imam Rabbani e sheh këtë sëmundje si «sëmundja e kafshatës me yndyrë» dhe mistikët e

vërtetë i përshkruan kështu: «(Sufitë e vërtetë) nuk kënaqen me gjëra të vogla përderisa kanë diçka të vlefshme. Ata nuk e braktisin gjënë e vlefshme e cila pranohet me kënaqësi dhe nuk priren ndaj një interesi të kësaj bote që ka marrë zemërimin e Zotit. Ata nuk e shesin veten kundrejt kafshatave me yndyrë dhe të shijshme. Kënaqësinë që e marrin nga adhurimi ndaj Zotit nuk e ndryshojnë me veshje të holla e të zbukuruara. Ata e pranojnë si turp që ta ndotin këtë fron të mbretërimit me pisllekun dhe papastërtinë e interesave të kësaj bote. Ata përmbahen nga bërja ortak e Latit dhe Uzzasë në pronën e Zotit dhe e konsiderojnë këtë një paturpësi.» (Mektubat, vëll. 1, Letra e 174-t.)

Shumë njerëz, të cilët duket se janë fetarë kohët e fundit, nuk i pranojnë dispozitat e qarta të Islamit për shumë çështje si trashëgimia, martesë, divorci dhe allishverishi. Ata mund t’i injorojnë këto dispozita ngaqë nuk u përshtaten interesave të tyre. Si rrjedhojë, shkojnë pas interesave të kësaj bote, të cilat mund të konsiderohen Lati dhe Uzza të kësaj periudhe, jo pas dispozitave të Allahut. Megjithatë, një mysliman i sinqertë nuk mund ta marrë diçka që nuk ia ka dhënë Allahu si të drejtë, edhe nëse ligjet e lejojnë këtë, nga dikush tjetër si e drejtë e tij. Ai nuk mund ta marrë dhe ta hajë diçka që e ka ndaluar Allahu, edhe nëse shoqëria e toleron. Nëse vepron kështu (pra, e merr edhe pse e ka ndaluar Allahu), do të thotë se e ka shitur fenë me para aq sa fitimi që ka marrë.

Së fundi, si shtesë ndaj dijetarëve dashakeqë, edhe ata që dalin në emër të tarikatit dhe mashtrojnë njerëzit, hyjnë në grupin e atyre që e sigurojnë jetesën duke shitur fenë. Ndërsa miqtë e vërtetë të Allahut i kufizojnë shpenzimet e tyre dhe të familjeve të tyre duke u dhënë nxënësve dhe të varfërve, si kundër këtyre, njerëzit e tillë që hiqen si mistikë arrijnë të mbledhin pasuri duke shfrytëzuar ndjenjat shpirtërore të njerëzve. Fatkeqësisht, personat e tillë i bëjnë dëmin më të madh Islamit dhe mistikëve të sinqertë dhe e lëkundin besimin e njerëzve ndaj të mëdhenjve shpirtërorë.

Zoti (xh.xh.), na e mundësoftë ta zbatojmë fenë tonë të bukur në këto kohë të vështira që po kalojmë! Na ruajt të gjithëve nga shitja e saj me tundimin e nefsit dhe të shejtanit! Amin!



Fundi i atij që shet besëlidhjen është poshtërim

Në jetën tuaj, disa nga urdhrat e Allahut të Madhëruar përmbushen, disa prej tyre jo. Ju filloni t'i refuzoni disa prej tyre, duke thënë se në të vërtetë nuk janë ashtu. Ja pra, këtyre Allahu, azze ve xhel-le, u thotë: “Tashmë, dënimi i atyre që e bëjnë këtë prej jush nuk është tjetër veçse poshtërim në jetën e kësaj bote. Në Ditën e Gjykimit ata do t'i nënshtrohen dënimit më të rëndë, sepse Allahu nuk është i paditur për atë që bëni ju.”



Prof. dr. Halis Ajdemir

Shitja e fesë është një koncept i rëndësishëm. Gjithashtu nuk është një koncept që e kemi nxjerrë në ditët e sotme. Allahu i Plotfuqishëm e përdor atë në Kuranin e Shenjtë. Ka edhe përdorime të tjera përveç shitjes së vetes në rrugën e Allahut, azze ve xhel-le, apo në rrugën e shejtanit. Koncepti i shitjes është siç e përdorim ne; pra, përdoret në kuptimin e shkëmbimit si shitja e një shoku, besnikërisë, bashkimit, miqësisë, etj.

Që nga momenti që nisemi për të bërë një besëlidhje me Allahun dhe për të bërë një jetë të denjë ndaj Tij, para nesh shfaqen udhëkryqe. Në këto kryqëzime, çdo tabelë që na fton të largohemi nga drejtimi është në fakt një tabelë shitjeje. Nëse devijojmë nga rruga, do të ndahemi nga besëlidhja me Allahun (xh.sh.). Kur u realizua besëlidhja e parë ndaj Pejgamberit në Akabe, një sahab tha: “As ne nuk do të largohemi nga ana jonë, as ti nuk do të heqësh dorë nga ajo që na ke ofruar.” Kjo do të thotë, ne e kemi përvetësuar këtë besëlidhje, e kemi pranuar atë, e kemi zbritur në zemrat tona dhe e kemi dashur atë; për këtë arsye, jetën tonë të mbetur do ta harxhojmë për këtë kauzë. Ka prej njerëzve që e shesin veten në rrugën e kënaqësisë së Allahut (xh.xh.). Ata kanë pasuri, e shesin, kanë jetën, e shesin. Kjo është gjithashtu një shitje; robi e shet veten. Kjo nuk është një gjë e keqe, sepse blerësi i saj është shumë i vlefshëm. Blerësi është Zoti i robit. Edhe Ai në fakt e ka shprehur këtë siç vijon: **“Allahu e ka blerë pasurinë dhe jetën e besimtarëve në këmbim të xhenetit.”** (Teube, 111)

Domethënë se patjetër do të ketë një allishverish. Me disa mundësi që na janë dhënë, ne do të paraqesim këtu atë që aspirojmë me këto mundësi. Nëse i çojmë dëm këto mundësi, atëherë Allahu i Madhëruar shprehet kështu se cili do të jetë rezultati: **“Ata hoqën dorë nga udhëzimi dhe blenë herezinë, por tregtia e tyre nuk ishte fitimprurëse.”** (Bekare, 16) Ne do të hyjmë në një tregti, por duam të hyjmë në një tregti fitimprurëse. Madje, kjo le të jetë “tixharaten len tebur”, pra një tregti e tillë që nuk do të ketë asnjë humbje dhe nuk do të ketë fund. Ne të gjithë e ndjekim një tregti të tillë. Disa prej nesh e ndjekin në vendin e duhur, disa prej nesh e ndjekin aty ku nuk duhet.

ZHVESHJA NGA AJETET

Jeta e Karunit është një shembull i shitjes në këtë këndvështrim. Ai ishte nga populli i Profetit Musa (a.s.). Allahu (xh.xh.), e përmend Karunin si shembull për këtë duke u shprehur: «Ne i dhamë atij argumentet Tona, por ai u zhvesh (largua) nga ato.» Ai iu kthye kësaj bote me një pritje të pafund. Kjo është aventura e kërkimit të përjetësisë në një vend që nuk është i përjetshëm. Është shitja e besëlidhjes me Allahun Teala për një çmim të vogël. Shprehja zhveshje që përdoret në ajet është e rëndësishme. Ndërsa e shpjegoj këtë, jap një shembull nga i Dërguari i Allahut (a.s.), të cilin e quajmë «mësim duke dhënë shembull». Ndërsa Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, po kalonte pranë një djaloshi, pa se ai po përpiquej t'i hiqte lëkurën deles me një thikë që kishte në dorë. «Largohu

pak!», i tha atij, duke e kapur lëkurën dhe duke e bërë dorën grusht. Ai e futi dorën midis barkut dhe lëkurës duke e hequr atë lehtësisht. Ajetet e Allahut të Madhëruar përkujnë një për një me qenien e njeriut, duke e mbështjellë atë siç mbështjellë lëkura trupin. Që njeriu të zhvishet nga ajetet, duhet të bëjë një përpjekje si Karuni për t'u zhveshur prej tyre, sepse ajetet ndërveprojnë me lëkurën e njeriut dhe shtrihen e ndikojnë deri në zemrën e tij. Kjo është si gjendja e një çelësi që gjen vendin e tij.

Nëse një njeri dëshiron të zhvishet nga ajetet e Allahut, të cilat janë kaq të integruara me të, (të mos harrojë se kjo gjendje) është pothuajse sikur të detyrohet të zhvishet nga lëkura e tij. Për këtë arsye, kur njeriu thotë të jetojë i vetëm, nuk mund ta bëjë atë lehtë, sepse Allahu, i Cili është i Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti, nuk heq dorë aq lehtë nga robi i Tij. Pandehet se rruga e mosbesimit është e lehtë, rruga e besimit është e vështirë. Jo, rruga e mosbesimit është më e vështirë, sepse Allahu (xh. sh.), krijon pengesa në rrugën e mosbesimit, në mënyrë që robi të kthehet tek Ai. Njeriu duhet t'i kapërcejë këto pengesa një nga një, me forcë dhe me kokëfortësi. Mirëpo, në rrugën e besimit, siç thotë Allahu në hadithin kudsij, një njeri i cili i afrohet Atij një pëllëmbë, Ai i afrohet një pash. Të thuash që do të bëj jetën timen dhe tani e tutje rregullat e jetës sime do t'i vendos vetë, është një rrugëtim i vështirë.

NE SPROVOHEMI EDHE ME MIRËSI, EDHE ME TË KEQE...

Tani zgjedhja është para nesh, ajo që kërkojmë është përjetësia, nuk duam të vdesim e të zhdukemi. Kemi shijuar ngrënien, pirjen dhe shijet e tjera, na pëlqyen shumë. Mirësitë e krijuara nga Allahu i Madhëruar janë madhështore. Andaj dëshirojmë që këto të kthehen në mirësi të përhershme dhe të vazhdojnë duke u diversifikuar në lloj-lloj ngjyrash. Këtë e duan edhe jobesimtarët, e duam edhe ne. Allahu Teala tashmë na e ka premtuar këtë: **“O njerëz! Premtimi i Allahut absolutisht është i vërtetë. Mos lejoni që jeta e kësaj bote t’ju mashtrrojë.”** (Fatir, 5) Pra, nëse arsyetojmë, do ta dimë se ajo që kërkojmë nuk është këtu. Ai thotë se ato që kemi pranë, mbarojnë. “Këtu nuk ka asgjë, ndoshta diçka do të dalë atje...” Besimi nuk është i tillë. Kjo nuk është hedhje e një zari, por të ndjekësh një thirrje të vërtetuar. Krijuesi i qiejve dhe i tokës e ka vërtetuar fuqinë e Tij. Për këtë arsye, nga rinia e deri në pleqëri, jemi gjithmonë përballë zgjedhjes së blerjes. Në ajet thuhet: **«Allahu nuk**

do t’i lërë besimtarët ashtu siç janë, pa e ndarë të papastrin nga i pastërti.» (Al Imran, 179) Kjo do të thotë se kushtet do t’i ndryshojë. Për shembull, nëse do të kisha më shumë mundësi financiare dhe nëse do t’i jepja fund premtimit ndaj Allahut e do ta shisja, Allahu do të më jepte edhe më shumë, sepse ngaqë Allahu i Madhëruar e di të fshehtë, Ai i di edhe zbrazëtitrat në nënshtrimin tonë. Këto janë si sëmundjet e zemrës. Pastaj i ndryshon kushtet tona në përputhje me rrethanat. Nëse kam prirje për pasurinë, ai do të më japë pasuri, në mënyrë që jetë e qartë besnikëria ime ndaj besëlidhjes sime. **“A mendojnë ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre se Allahu nuk do t’ua zbulojë atë që kanë në brendësi të tyre?”** (Muhamed, 29) Megjithatë, nëse nuk heq dorë nga Zoti për çfarëdo që të posedoj dhe nuk e thyej premtimin tim ndaj Tij, kjo është ajo që do të më dalë përpara. Allahu, azze ve xhel-le, sheh dhe di gjithçka për ne. Prandaj, me një nënshtrim të mëparshëm, njeriu duhet t’i plotësojë boshllëqet e tij. Siç kanë sprovë gjërat e mira, ka edhe shembuj të dhimbshëm për këtë. Kur vjen e keqja, mund të jetë e mundur edhe shitja. **“Ne ju sprovovmë edhe me të keqen, ju sprovovmë edhe me të mirën.”** (Enbija, 35) Të gjitha këto janë sprova dhe nuk janë të përhershme. Mund të ketë edhe nga ata që thonë se nëse Allahu ma merr fëmijën, unë do të rebelohem ndaj Tij. Mund të shfaqet rebelim në formën: Po falem, agjëroj, pse ma mori fëmijën? Edhe nëse njeriu nuk e thotë këtë, por nëse e ndjen përbrenda, aty ka një problem. Është si t’i thuash Zotit se nuk mund ta marrësh... Por çfarë duhet të thotë? O Zot, ti mund ta marrësh ashtu siç e ke dhënë. Madje mund ta marrësh edhe shpirtin tim. Unë nuk mund të them që nuk mund ta marrësh. Por unë jam robi Yt i pafuqishëm, po të lutem paraqishtë, mos më jep ditë të dhimbshme, mos më sprovo me dhimbjen e humbjes së fëmijës.

FRIKA NA MBAN GJALLË

Allahu i Plotfuqishëm regjistron gjithçka rreth nesh, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. **«Ne marrim një kopje të çdo gjëje që keni bërë.»** (Xhathije, 29) Edhe për ato që i bëni me duar, edhe për ato që i bëni me zemër... Nëse themi: «Unë do të heq dorë nga besëlidhja nëse ma merr pasurinë, fëmijën dhe pozitën.», atëherë ka një problem në dorëzimin tonë ndaj Tij, sepse dorëzimi është siç thotë Ibrahim: **“Kur Zoti i tha dorëzohu, (ai tha) unë iu dorëzova Zotit të botëve.”** (Bekare, 131) Sprova është sunet i Allahut të Madhëruar. Ai nuk ka thënë: «Ky është Ibrahim, le të mos e sprovovmë atë.» **«Një herë e**

një kohë Zoti e sprovoi Ibrahimin me disa fjalë.» (Bekare, 124) Por çfarë Ibrahim i mrekullueshëm ishte ai, që Zoti i Plotfuqishëm e përmend dëftesën e tij në këtë ajet: **“Ibrahimi i përmbushi ato plotësisht.”** I lutem Zotit që të na falë edhe ne, për hir të faktit që e kemi zili atë gjendje kur e lexojmë këtë ajet. Përndryshe, nuk kemi guxim të themi se jemi gati për këto sprova. Sido që të jetë, edhe i Dërguari i Allahut nuk na ka inkurajuar ta bëjmë këtë. Ai na ka mësuar t’i përgjërohemi Allahut duke thënë: “O Zot, na sprovo me gjëra të lehta, na dhuro qëndrueshmëri, na mbroj dhe na ruaj!” Ai na ka rekomanduar falënderimin. Nëse robi shfaq shumë mirënjohje ndaj Zotit, këto fatkeqësi ndalen. Në fakt fatkeqësitë janë gjërat që i sigurojnë robit vitalitetin dhe ndërgjegjen dhe që kontrollojnë nëse do ta shesë fenë e tij apo jo. Nëse është gati ta shesë, ato dërgohen që ai të kthehet me dhimbjen e tyre. Por nëse robi e mban vetëdijen e tij të lartë dhe krijon perceptimin se fatkeqësitë do t’i sjellin përfitime, shpresohet që Allahu ta çlirojë atë rob nga ato fatkeqësi. Kjo është shpresa jonë.

Ai që i frikësohet zemërimit të Allahut të Madhëruar, Zoti e çon atë drejt nivelit më të mirë për sa i përket përkushtimit dhe besnikërisë. Robi i vërtetë në fakt është i shqetësuar për Allahun e Plotfuqishëm për shkak të mëkateve të tij edhe në situatën e tij aktuale. Ai është në frikë me mendimin: «A thua do të më ndëshkojë? Si do ta kënaq Allahun?» Njerëzit e tillë lavdërohen: “Ata janë mushfik ndaj dënimit të Zotit të tyre.” (Mearixh, 27) Në arabisht < mushfik’ apo «eshfaka ala» do të thotë të jetosh me frikë se çfarë do të ndodhë. Kur e pyet pse, mëkatet e tij i vijnë në mendje. Mirë, por çfarë ndodh me ne? Ne themi se tashmë jemi penduar. Është sikur të kemi marrë një dokument nga Allahu, azze ve xhel-le, se na është pranuar pendimi. Ndërkohë, ne duhet ta ndjejmë pak peshën e pendimit tonë.

Flitet për pendimin e Junusit, (a.s.), në barkun e peshkut. Ai përjetoi shqetësim pas shqetësimi. Gjithashtu ne i njohim edhe tre sahabët në kohën e të Dërguarit të Allahut, për pendimin e të cilëve flitet shumë. Megjithatë, edhe nëse e kaluara fshihet (falen gjynahet e saj), ne prapë se prapë kryejmë mëkate të tjera. Nisur nga ky aspekt, nëse frika jonë është aktive, do të jemi kaq të sigurt se nuk do t’i shesim besëlidhjen dhe ajetet e Allahut. Frika na mban të shqetësuar, kurse të menduarit mirë për veten na çon më lehtë drejt rrezikut. Siç thonë, injoranti është trim. **“Dënimi i Allahut nuk është një dënim për të cilin njeriu mund të jetë i sigurt.”** (Mearixh, 28)



SPROVA E ZOTIT NUK KA NDRYSHUAR ASPAK

Ai që e shet fenë, së pari heq disa ajete nga praktika. Pas një kohe, fillon të mohojë dispozitën e ajeteve, për shembull thotë: «Çfarë të keqeje ka kamata?» Sot, ne jemi në një sprovë të ngjashme në botën moderne ku jetojmë. Sprova e Allahut të Madhëruar nuk ka ndryshuar asnjëherë në esencën e saj nga e kaluara në të tashmen. Ajo i ndryshon kushtet, por përdor të njëjtin shabllon, të njëjtën metodë. Ai i detyron robërit e Tij të zgjedhin mes të ashtuquajturave vlera në rritje në shoqëri dhe fesë. Dispozitat e Allahut në njërën anë dhe vlerat shoqërore në rritje nga ana tjetër.

Le të themi dispozita e kisasit. Allahu (xh.xh.), thotë se në këmbim të një jete të vrarë, nëse familja e viktimës dëshiron, vrasësi vritet. Tani bota humaniste thotë: “Oh, çfarë gjykimi brutal, çfarë gjëje e keqe. Një njeri nuk mund të dënohet duke u vrarë.” Tashmë këtë po e trajtojnë aq shumë saqë po bëhet e pranueshme parapakisht. Por kush do të vendosë nëse kjo është e drejtë apo jo, dhe nëse ajo që thotë Allahu i Madhëruar, që është alternativë e saj, është e drejtë apo jo? Ja pra, për këtë arsye është krijuar kjo botë. Zoti krijoi vdekjen dhe jetën për të sprovuar njerëzit. Kjo vjen si një zgjedhje para njeriut. Çfarëdo që thotë Allahu i Madhëruar, ajo është e vërtetë. Njerëzit nuk duhet të mashtrohen nga fakti që çështja glorifikohet në media apo shoqëri.

Profeti Ibrahim ishte një fëmijë i vogël. Ai i tha Nemrudit dhe një shoqërie që ishte formësuar me mllef të tij: **“Me të vërtetë, as ju, as idhujt tuaj, nuk mund të mashtroni askënd kundër (Atij).”** (Saffat, 161-162) Pra, nuk mund ta ngatërroni atë. Kë mund të mashtroni ju? Ju mund të mashtroni



vetëm atë që hidhet në zjarr duke vrapuar kështu. Kjo është arsyeja pse mendja është një mirësi e madhe... Për më tepër, Allahu i Plotfuqishëm na mban nën kontroll të vazhdueshëm: **“Kudo që të jeni, Ai është me ju.”** (Hadid, 4)

FEJA APO VLERAT BASHKËKOHORE?

Gjykimet dhe vlerat që po ngrihen në mjedisin e sotëm kanë një efekt negativ në rininë tonë dhe veçanërisht tek vajzat tona. Për shembull, ekziston një diskurs feminist.

Ai ka pretendime të tilla për krijimin sa që duket se përfshin rebelim kundër dallimeve të roleve themelore. Islami i ka përcaktuar njerëzit me burrat dhe gratë si familje dhe u ka dhënë role, detyra e përgjegjësi të caktuara. Ai në thelb e ka konsideruar secilin prej tyre si një individ ekuivalent që mund të bëjë jetën e tij dhe të fitojë xhenetin. Ne të gjithë jemi fëmijë të Ademit (a.s.). Kur të ketë çështje që bien ndesh me këtë shabllon, atëherë, a do t'i marrë njeriu për bazë ajetet e Allahut (xh. xh.), apo do të bazohet në vlerat që lartësohen sot, të cilat nëse mendohet pak rreth tyre, do të shihet se janë të pavërteta? Çmimi i kundërshtimit të tyre sot është si të kundërshtosh zakonet e asaj dite në Mekë. Sot fetarët poshtërohen duke iu thënë se në çfarë bote jetoni, ashtu siç përçmoheshin atë ditë ata që kundërshtonin vlerat, parimet, zakonet, jetën, traditat – dua të them të gabuarat – të vendosura nga paraardhësit e Mekës së asaj kohe. Por njeriu duhet të thotë se gjëja më e rëndësishme për mua është e drejta. Unë lexoj, studioj, hulumtoj. Cilado të jetë e vërteta, unë i nënshtrohem asaj. Unë i them të vërtetës e vërtetë. Allahu i Madhëruar i udhëzon në rrugë të drejtë të gjithë ata që nisen nga ky këndvështrim: **“Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugën e drejtë.”** (Ahzab, 4)

ALLAHU NUK HEQ DORË LEHTË NGA ROBI I TIJ

Shumë njerëz e mohojnë atë që nuk e kuptojnë. Ata e refuzojnë atë nga larg para se ta kuptojnë. Dhe thonë: “Këto janë fjalët e të parëve, arabët i kanë shpikur, u bënë 1400 vjet që nuk po shpëtojmë dot.” Mos vallë kanë lexuar e studiuar dhe e kanë vënë re se është gabim? Jo, por e bëjnë këtë nga larg, sipas zakoneve të përgjithshme të jobesimtarëve. Pse? Sepse preferojnë këtë botë, të cilën e kanë dashur që më parë. Ata thonë se, edhe nëse alternativa është e drejtë, pasionin e kësaj bote nuk e ndryshojnë me asgjë tjetër. Për këtë arsye, nuk ndiejnë nevojë për asnjë hulumtim. Allahu i Madhëruar thotë: **«Ata preferojnë jetën e kësaj bote kundrejt botës tjetër.»** (Ibrahim, 3) Ata e kanë mbyllur veten ndaj opsionit të botës së përtejme ngaqë e shohin jetën e kësaj bote si më të këndshme. “A do ta bësh të dëgjojë atë që është në varr?”, thotë Zoti. Ky lloj njeriu e ka izoluar veten si në varr. Disa i shikojnë këta lloj njerëzish dhe pyesin: “Ata nuk i dinë ajetet, nuk e dinë Kuranin, a do të ndëshkohen?” Ky lloj njeriu e ka bërë zgjedhjen e tij që në fillim dhe e ka shitur besëlidhjen me Zotin që në minutën e parë. Ai thotë si Ebu Xhehli: “Nuk dua të dëgjoj asgjë për Krijuesin dhe për krijimin. Unë dua të jetoj sipas parimeve të mia.” Përkundër kësaj, Zoti i Madhëruar i dha edhe Ebu Xhehlit vështirësi dhe telashe. **«Ne do të bëjmë që të shijojnë një dënim më të lehtë në këtë jetë, para dënimit më të madh në jetën e përtejme, me qëllim që të kthehen në rrugën e drejtë.»** (Sexhde, 21) Me fjalë të tjera, robi e shet besëlidhjen paraprakisht, por Allahu i Madhëruar thotë: «Unë nuk heq dorë lehtë nga ti.» Zoti i bën të përjetojnë vështirësi dhe fatkeqësi, në mënyrë që njerëzit të kthehen. Sa shpesh përmendet kjo shprehje në Kuran: «Shpresohet që të kthejnë.» Por kur robi nuk heq dorë nga kokëfortësia e tij dhe e aprovon fjalën e tij se «sado që të më bësh të jetoj, injorimi im për Ty nuk do të ndryshojë», ai i mbyll sytë ndaj kësaj jete me një gjynah të jashtëzakonshëm që meriton një ndëshkim të pafund. Ata që shkatërrohen, humbasin në bazë të dëshmimeve të tilla, dhe ata që jetojnë, jetojnë me dëshmi të tilla. (Shik. Enfal, 42) Jeta nuk është një vend ku Allahu i Madhëruar sprovon gënjeshtat dhe gabimet. Si mësues, humbjet në provimet tona, gabimet e matjeve dhe vlerësimit, janë unike për ne. Allahu i Plotfuqishëm e sprovon robin e Tij aq mirë dhe e vë në sprovë kaq të mirëfillta me zemrën e tij, me

botën e brendshme të tij dhe me botën e jashtme të tij... Së fundi, kur t'i fusë zullumqarët në xehenem, asnjë nga këta zullumqarë nuk do të thotë dot se atij i është bërë padrejtësi: *"...Rojtarët e tij do t'i pyesin ata: "A nuk ju erdhi ndonjë paralajmëruar?!" "Po - do të përgjigjen ata - na kanë ardhur vërtet paralajmëruar, por ne i quajtëm ata gënjeshtarë dhe thamë: "Allahu nuk ka shpallur asgjë; ju jeni në një humbje të madhe!"* (Mulk, 8-9) Më pas i rrëfejnë krimet e tyre duke thënë: "Ne e kemi merituar këtë."

FUNDI I ATIJ QË SHET BESËLIDHJEN ËSHTË POSHTËRIM

Tani, kjo pikë është e rëndësishme për ata që akoma janë në fillim të jetës. Le të themi se në jetën tuaj, disa nga urdhrat e Allahut të Madhëruar përmbushen, disa prej tyre jo. Ju filloni t'i refuzoni disa prej tyre, duke thënë se në të vërtetë nuk janë ashtu. Ja pra, këtyre Allahu, azze ve xhel-le, u thotë: "Tashmë, dënimi i atyre që e bëjnë këtë prej jush nuk është tjetër veçse poshtërim në jetën e kësaj bote. Në Ditën e Gjykimit ata do t'i nënshtrohen dënimit më të rëndë, sepse Allahu nuk është i paditur për atë që bëni ju." Ekuivalenti i fjalës «hizj» në ajet është poshtërim. Shikoni, ne si myslimanë kemi shumë para. Por, a kemi reputacion në këtë botë me këto para? Jemi në një gjendje të turpshme.

Pavarësisht nga të gjitha pasuritë tona nëntokësore dhe mbitokësore në gjeografinë e umetit, reputacioni ynë është për tokë. Diktatorëve tanë, perëndimi ua shet armët në këmbim të të gjitha parave të tyre. Paratë tona nuk kanë asnjë vlerë. Jeta jonë nuk ka shije. Sepse njeriu e dëshiron prestigjin para pasurisë së tij. Madje edhe politeistët kurejshë ndiqnin reputacionin. Për këtë arsye, Allahu (xh.xh.), na bën të përjetojmë poshtërim. Në këtë aspekt, robi që shet besëlidhjen me Allahun hyn në këtë periudhë të trazuar në jetën e tij të kësaj bote.

Pasi Allahu thotë: "Ajo që është te ju mbaron, kurse ajo që është tek Allahu është e përhershme.", shprehet: *"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë."* (Nahl, 97) Cilido qoftë roli, mashkull apo femër, mos u varni pas roleve. Qoftë i pasur apo i varfër, shef apo nëpunës civil, pasi të bëjë vepra të mira, do t'i japim një jetë të bukur besimtarit. Ai thotë një jetë të bukur,

jo një jetë të pasur apo me pozitë të lartë. Në jetën e kësaj bote njeriu mund të jetë i çuditshëm, por ka një jetë të bukur. Krijuesi ynë është Allahu (xh. xh.) dhe të gjitha gjërat brenda nesh i përkasin Atij. Të gjitha rregullimet tona janë në duart e Zotit të Plotfuqishëm.

NUK DO TË JEPET EDHE NJË MUNDËSI TJETËR

Nuk ka se si të harrohet fakti që kjo botë është një vend sprove dhe se është e pamundur të thuhet se po e lë sprovën. Nëse veproni në këtë mënyrë, pra nëse tentoni t'i ikni sprovës, thjeshtë po thoni se doni ta përjetoni sprovën në dimesionin negativ. Edhe në atë dimension negativ, Zoti nuk heq dorë kollaj prej teje dhe të bën të përjetosh shumë gjëra. Allahu i Madhëruar e bën këtë, në mënyrë që kur të dalësh në audiencën e Tij, të mos thuash: "O Zot, sikur të më kishe detyruar pak, sikur të më kishe imponuar. Sikur të mos më kishe lëshuar menjëherë ngaqë i isha drejtuar të keqes, sikur të më kishe ngritur, sikur të më kishe dhënë telashe pas kësaj, ashtu që të vija në vete.» Çfarëdo që të thotë njeriu, ky i fundit do të vërë re se Allahu Teala tashmë i ka bërë të gjitha ato kundrejt tij. Por pavarësisht kësaj, ai njeriu ka vazhduar ta shesë besëlidhjen që kishte me Zotin. Pastaj këta lloj njerëzish do të thonë: *"Zoti ynë! Pamë dhe dëgjuam. Na kthe që të bëjmë gjërat sipas vullnetit Tënd, tani besojmë me siguri!"* (Sexhde, 12) Por Allahu (xh.xh.), nuk do të hapë më derë për ata që shitën besëlidhjen dhe përfunduan me një fund kaq të keq.

Gjatë viteve kur po bëja hafizllëkun, e lexoja këtë ajet dhe thosha: "O Zot! Ah sikur t'i dërgosh! Ata po të betohen dhe po të përgjërohen. Ndoshta do të ishte më mirë të ktheheshin. A nuk mund t'u jepet një mundësi tjetër?" Pastaj pashë këtë ajet: «Përndryshe, edhe nëse dërgohen pas, do t'u kthehen përsëri gjërave të ndaluara.» (En'am, 28)

Aty e kuptova se Allahu i Madhëruar ua ka dhënë një shans të dytë të gjithë atyre që do t'ua jepte një shans të dytë në këtë jetë. Ai ua ka dhënë edhe një shans të tretë të gjithë atyre që do t'ua jepte një shans të tretë në këtë jetë. Ai gjithashtu ua ka dhënë edhe një shans të katërt atyre që kanë nevojë për një shans të katërt.

Secilit prej atyre që do të rregullohej me ndonjë mundësi, Ai patjetër ia ka dhënë atë. Pra, kë e ka hedhur Allahu (xh.xh.)? Ai ka hedhur vetëm ata që nuk bëhen njerëz çfarëdo që t'u japë prej mundësive

dhe shanseve. Allahu i Madhëruar në fund u drejtohet atyre që kërkojnë afat me këmbëngulje: **«Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?!»** (Fatir, 37) Kur ata ta dëgjojnë këtë, ulin kokat e tyre.

Është edhe kjo çështje e mëposhtme për shitjen e vetes nga ana e njeriut: **«Ka disa njerëz që sakrifikojnë veten për të marrë pëlqimin e Allahut.»** (Bekare, 207) Aliu, për shembull, u shtri në shtratin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Atë natë do të shkolin dhjetë burra që synonin të vrisnin të Dërguarin e Allahut. Këtë e dinin të gjithë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e la atë në vend të vet dhe i tha që amanetet t'ua jepte të nesërmen pronarëve të tyre. Por ky është informacion i dhënë nga i Dërguari i Allahut. Në fakt si ishte realiteti? Realiteti ishte se atë natë do t'i bënin atentat personit të shtrirë në atë shtrat. Por ai duke i besuar të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte i gatshëm ta sakrifikonte veten edhe nëse do ta vrisnin.

LE TË MËSOJMË SE KUJT T'IA SHESIM VETEN

Të mos e shesim besëlidhjen dhe fenë e Zotit, ta mësojmë shumë mirë këtë çështje. Por le të mësojmë ta shesim veten mirë. Ata që nuk janë të gatshëm të shesin veten tek Allahu (xh.xh.), nuk mund të arrijnë rezultate. Allahu i Madhëruar thotë në ajet: **«Ata që shesin dynjanë në këmbim të ahiretit, le të luftojnë në rrugë të Allahut.»** (Nisa, 74) Ne si komb, gjithmonë kemi jetuar me këtë frymë. Allahu (xh.xh.), i lartësoi të parët tanë me Islam. Për këtë arsye, ata luftuan në vijën e parë me jetën e tyre, e sakrifikuan veten dhe bënë çlirime. Shitja e vetes për këtë kauzë ishte si një trashëgimi brez pas brezi, nga babai te fëmijët për ne.

Unë jam i diplomuar në Shkollën e Mesme Erzurum. Ndërtesa e Shkollës së Mesme të Erzurumit është një strukturë e bukur guri. Me të vërtetë mahnitëni kur e shikoni. Atë e ka ndërtuar Sulltan Abdylhamit Hani, qoftë i xhenetit, në vitin 1880. Kur shkova për herë të fundit, pashë silueta në pjesën e jashtme. Mua normalisht nuk më pëlqen kjo lloj gjëje. Kishte të rinj radhë-radhë. Format e bëra dukeshin si idhuj. Pyesja veten pse i kishin vendosur? Në tabelë gjendet historia e Shkollës së Mesme të Erzurumit. Aty thoshte: Ka nxjerrë të diplomuar që nga dita kur është themeluar e deri më sot, por nuk ka nxjerrë të diplomuar midis viteve 1915 dhe 1918.



Pse? Sepse nxënësit midis moshës 12-17 vjeçare në Erzurum, të cilët ishin afër 500 nxënës, shkuan në Çanakkale. Ata përmbushën urdhrin hyjnor: «Ata që shesin dynjanë në këmbim të ahiretit, le të luftojnë në rrugë të Allahut.» Ata që nuk janë të gatshëm të shesin jetën e tyre në këtë botë, nuk mund të blejnë botën tjetër. Kështu shprehet edhe në tregti: Ai e bleu këtë. Ja pra, pikërisht kështu.

Njeriu duhet të përpiqet të arrijë pjekurinë në një nivel që të shesë dynjanë dhe të blejë botën tjetër në gjendjen e tij shpirtërore. Kjo arrihet me dije, me të mësuar. Kjo arrihet duke e mësuar atë që premtun Allahu, fuqinë e Tij dhe pastaj duke e përjetuar. Që nga ajo kohë (periudha osmane) e deri më sot, ka kaluar një shekull. Andaj duhet ta rimarrim atë frymë që mund ta shesë këtë botë për hir të botës së përtejme, madje që mund ta bëjë këtë në pranverën e jetës. Së pari kemi nevojë për të hequr dorë nga shitja e fesë së Zotit të Plotfuqishëm. Pastaj edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Kjo nuk është e mjaftueshme për Allahun (xh.xh.). Pastaj duhet të jemi gati për luftë kundër qafirëve me jetën dhe pasurinë tonë. Sigurisht që ne nuk jemi entuziastë të luftës. Por ne luftojmë kundër atyre që janë armiq me ne, që na sulmojnë dhe duam të shtrijmë duart e tyre në faltoret tona siç ndodhi në Çanakkale. Nëse lufta do të vijë, mund të mbijetojmë vetëm me një frymë që e sakrifikon jetën. Të rinjtë dhe shoqëria që do të ngremë me këtë frymë mund të vazhdojnë vetëm në këtë gjeografi. Një shoqëri që nuk di ta shesë jetën dhe pasurinë për hir të Allahut (xh.xh.), pas një kohe fillon të shesë fenë e saj. Ajo u shet qafirëve vlerat e saj. Pas kësaj, shet ekzistencën e vet dhe mbetet pa personalitet në një proces që shtrihet deri në shitjen e nderit.

“AI E SHET FENË PËR NJË INTERES TË THJESHTË”

Nuk ka asgjë më të neveritshme se sa njeriu ta vërë në shitje fenë e vet.

Kështu, kur Imam Maliku u pyet: «Kush është bastard?», ai u përgjigj: «Është ai që e bën fenë e tij kapital dhe e ha atë.»

— Dr. A. Hamdi Jëlldërëm —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: «*Këta janë ata që blenë humbjen në këmbim të udhëzimit, por tregtia e tyre nuk u dha dobi dhe nuk gjetën rrugën e drejtë.*» (Bekare, 16)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*Nxitoni të bëni vepra të mira, para se të shfaqen trazirat, të cilat janë si pjesë të natës së errët. Kur të shfaqen ato trazira, njeriu gdhahet si besimtar dhe ngryset si jobesimtar; ngryset si besimtar dhe gdhahet si jobesimtari. Ai e shet fenë për një interes të thjeshtë të kësaj bote.*” (Muslim, Iman: 186; Tirmidhi, Fiten: 30.)

Fjala tregti përmendet nëntë herë në tetë ajete të Kuranit Fisnik me kuptimet e saj pozitive dhe negative. Të ardhurat e politeistëve mekas bazoheshin

në tregti dhe përbënin një pjesë të rëndësishme të jetës së tyre. Për ta, tregtia duhej të ishte fitimprurëse. Ja pra, pikërisht për çështjen të cilës ata i kushtonin më shumë rëndësi, Allahu i Madhëruar thotë: “Tregtia e tyre nuk u solli dobi. Ata pësuan humbje.” Në të vërtetë, është e pamendueshme që shitja e udhëzimit dhe marrja e çoroditjes të jepte ndonjë rezultat tjetër.

Ashtu si tregtia e kësaj bote bazohet në fitim, edhe tregtia e botës së përtejme bazohet në fitim. Ndërsa fitimi i tregtisë së kësaj bote llogaritet mbi pasurinë, fitimi i ahiretit deklarohet në ajetet e mëposhtme të sures Saff:

«O ju që keni besuar! A doni t’ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t’ju falë gabimet tuaja dhe do t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe. Ai do t’ju falë edhe dhunti të tjera që, i dëshironi: ndihmën e Tij dhe një fitore të afërt! Andaj, gëzoji besimtarët!» (Saff, 10-13)

Nuk ka mashtrim, gënjeshtëri apo dredhi në tregtinë e botës tjetër që bëhet me Allahun (xh.xh.). Në këtë tregti, Allahu Teala merr nga robi i Tij pasurinë,



jetën dhe gjërat më të vlefshme të tij. Robi i plotëson të gjitha këto me pëlqim dhe ia nënshtron punën e tij vullnetit dhe gjykimit të Allahut të Madhërishtëm. Në fakt, në ajetin e 111-të të sures Teube, Allahu deklaroi se e ka marrë jetën dhe pasurinë robit të Tij në këmbim të xhenetit.

Nga ana tjetër, stolitë mashtruese dhe magjepsëse të jetës së kësaj bote i kanë larguar disa njerëz nga rruga e drejtë dhe i kanë devijuar nga e vërteta. Ata janë zhytur në këtë botë. Ata preferojnë të shkaktojnë çoroditje, mosbesim dhe anarki në këtë botë. Botën tjetër të tyre e kanë shkatërruar duke dhënë udhëzimin dhe duke marrë herezisë në këmbim të tij. Siç shprehet në hadithin fisnik, ata e kanë shitur fenë e tyre për një interes të thjeshtë të kësaj bote. Nuk ka asgjë më të neveritshme se sa njeriu të vërë në shitje fenë e vet. Në fakt, kur Imam Maliku u pyet: «Kush është bastard?», ai dha këtë përgjigje: «Është ai që e bën kapital fenë e tij dhe e ha atë.» Kur u pyet: «Kush janë njerëzit më të ulët?», ai u përgjigj: «Janë ata që e shkatërrojnë fenë e tyre për të ndërtuar botën e të tjerëve.»

Njerëz të tillë do të shumohen me kalimin e kohës. Në të vërtetë, Profeti (a.s.), thotë se trazirat do të shtohen afër kiametit. Si pjesë të natës karran i zi, këto trazira po na rrethojnë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ka folur për një periudhë kohe kur njerëzit do ta humbasin besimin nga mbrëmja në mëngjes dhe nga mëngjesi në mbrëmje, për të shpjeguar shkakun e kësaj, shprehet se ky lloj njeriu e shet fenë e tij për një interes të thjeshtë të kësaj bote.

Interes i kësaj bote është çdo gjë që i ofrohet njeriut dhe e largon atë nga bota e përhershme; pra është prona, është pasuria, është dashuria për të qenë në krye, është familja... Shkurtimisht, një njeri që kërkon dynjanë në vend të Allahut, e ka vënë besimin e tij në rrezik. Megjithatë, ajo që pritet nga një mysliman është të sakrifikojë gjithçka për fenë e tij. Me fjalë të tjera, është që ta bëjë tregtinë e tij në favor të fesë. Një mysliman nuk mund ta bëjë fenë dhe devotshmërinë e tij burim të ardhurash. Ai nuk mund ta shesë fenë.

Shejtani ka një armiqësi të tmerrshme me Birin e Ademit (njeriun). Shejtani dëshiron ta çojë njeriun në rrugë të gabuar dhe t'ia vjedhë besimin. Ata që nuk mund t'i mashtrojnë drejtpërsëdrejti, përpiqet t'i devijojë në mënyra të ndryshme. Mënyra për të qenë i fortë kundër djallit është një tregti që mund të bëhet me Allahun Teala. Kjo tregti është një transaksion që nuk ka humbje, ndërprerje dhe falimentim, sepse feja në këtë tregti nuk është një mall për t'u shitur, por një vlerë për të cilën sakrifkohet gjithçka. Prandaj, (kjo tregti) nuk ka humbje. Allahu i Madhëruar na shpjegon natyrën e kësaj tregtie në ajetin fisnik siç vijon:

«Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë.» (Fatir, 29)

Sipas asaj që na informon ky ajet, robërit e mëposhtëm të Allahut janë në një tregti pa humbje:

- a) Ata që lexojnë Kuranin Fisnik,
- b) Ata që e falin namazin,
- c) Ata që shpenzojnë në rrugën e Allahut.

Këtë dhurim e bëjnë fshehurazi, varësisht nga vendi dhe haptazi, varësisht nga situata.

Këta njerëz janë myslimanë të lumtur. Ata mund të arrijnë fitimin edhe të kësaj bote, edhe të botës së përtejme. Sepse, ndërsa nga njëra anë fitojnë për këtë botë, nga ana tjetër, e shpëtojnë jetën e tyre të përtejme duke përmbushur detyrat fetare.

Shkurt, ka dy lloje tregtie: Njëra është ajo që bëhet me Allahun (xh.xh.), kurse tjetra është ajo që bëhet me këtë botë. Zgjedhja varet nga ne robërit. Ne do të zgjedhim ose të përjetshmen, ose të përkohshmen. Sado që të zgjasë kjo jetë e kësaj bote, ajo është e shkurtër, ajo vjen e shkon. Kurse bota tjetër është vendi i jetës së përjetshme dhe i pavdekësisë. Çfarë humbje/zhgënjimi i madh është të humbasësh një jetë të përjetshme për këtë botë të thjeshtë dhe kalimtare!

Zoti e bëftë gjithë umetin e Muhamedit prej myslimanëve të lumtur që kanë një tregti fitimprurëse me Allahun!.. Amin!



Kush janë robërit e veçantë të Rrahmanit?

Omer Çelik

Robërit e veçantë të Rrahmanit (Gjithëmëshirshmit) janë ata që ecin në tokë me pëkulësi dhe dinjitet. Ata që, pa u ndjerë të prekur prej atyre injorantëve që u hedhin fjalë, thonë: «Paqe!» - dhe kalojnë. Ata i kalojnë netët duke bërë sexhde për Zotin e tyre dhe duke qëndruar në audiencën e Tij. Allahu i Madhëruar thotë: «Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë; dhe ata që thonë: “O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm e ai është vendbanim dhe vendstrehim i keq.» (Furkan, 63-66)

Një nga cilësitë e bukura që Kurani Fisnik përdor për të lavdëruar besimtarët është shprehja «robërit e veçantë të Rrahmanit». Në këto ajete, duke filluar në formën: «Robërit e veçantë të Rrahmanit janë këta...», radhiten cilësitë e larta morale që duhet t'i bartin njerëzit që do të ngrihen në këtë shkallë shpirtërore:

Para së gjithash, përmendet mënyra e ecjes së tyre. Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë të tillë që, lëvizja, ecja dhe veprimi i tyre në tokë janë të buta. Ata nuk janë të ashpër, mburraveçë, arrogantë, mosrespektues, të vrazhdë dhe të pasjellshëm, por ecin me modesti dhe dinjitet, me pëkulësi dhe butësi, me edukatë dhe hijeshi. Ata nuk i shqetësojnë njerëzit përreth tyre, por ecin duke përhapur besim dhe paqe me sjelljen e tyre të respektueshme. Ata

nuk e sforcojnë veten ndërsa ecin dhe nuk bëjnë veprime të shtira. Ata nuk shfaqin as arrogancë, as mburrje. Ata nuk ecin as me hundë përpjetë, as duke u hapur. Sepse, si të gjitha sjelljet e njeriut, edhe ecja e tij është një tregues i personalitetit dhe emocioneve të tij. Një frymë normale, që i beson vetes, e vendosur dhe serioze i pasqyron këto tipare në ecjen e të zotit. Kështu, ai ecën normal, i sigurt, serioz dhe i vendosur. Përndryshe, «ata ecin duke hedhur hapa të butë në tokë», nuk do të thotë se ata ecin me kokën ulur, me shpatullat e rëna dhe duke u lëkundur si të vdekur. (Elmallëllë, Hak Dini, V, 3611; Sejjid Kutub, Fi Dhilal, V, 2577.)

Kur ecte i Dërguari i Allahut (a.s.), ecte drejt dhe me gjallëri. Ai ishte njeriun që ecte më shpejt prej njerëzve, më bukur dhe në mënyrë më të rehatshme. Ebu Hurejre (r.a.), thotë: «Unë nuk kam parë dikë më të bukur se i Dërguari i Allahut. Sikur dielli shkëlqente në fytyrën e tij. Gjithashtu, nuk kam parë njeri që ecte më shpejt se ai. Ndërsa ecte, toka dukej sikur mbështillej para tij. Kur ecnim me të, e kishim shumë të vështirë, por ai nuk e kishte problem.» Ali ibn Ebu Talibi (r.a.), thotë: «Kur ecte i Dërguari i Allahut, ecte sikur po zbriste nga lart.» Kurse edhe një herë tjetër tha: «Edhe kur ngitej përpjetë, ecte sikur po zbriste poshtë.» (Shik. Ibn Sa'd, et-Tabakat, I, 379-380.) Kjo është ecja e njerëzve të vendosur, të zellshëm dhe të guximshëm.

Së dyti, kur injorantët, domethënë ata që nuk e njohin veten e tyre, njerëzit pa edukatë u hedhin ndonjë fjalë, ata thonë «paqe». Ata thonë fjala që

përmbyllen me mirësi ose thonë «paqe». Ata ngaqë janë të preokupuar me seriozitetin, dinjitetin, vendosmërinë dhe idealet e mëdha që posedojnë, nuk janë të interesuar për marrëzitë e budallenjve dhe të njerëzve pa mend.

Ata nuk e çojnë dëm kohën dhe përpjekjet e tyre me njerëz pa mend, budallenj, duke luftuar e duke u grindur me ta. Ata qëndrojnë larg nga njerëzit budallenj dhe nga sjelljet e panevojshme. Këtyre lloj njerëzve u përgjigjen me fjalë të buta. Ata sillen butë ndaj atyre, sigurisht, jo ngaqë janë të dobët, por për të mos rënë në nivelin e tyre, jo ngaqë nuk kanë çfarë të bëjnë, por për shkak të ndjenjës së epërsisë. Ata përgjigjen me fjalë të buta ngaqë interesohen me vepra më të rëndësishme, më me dinjitet dhe më të larta, jo me gjëra boshe dhe punë budallenjsh, dhe ngaqë nuk duan ta harxhojnë kohën e përpjekjen e tyre të vyer me gjëra të papërshtatshme. (Elmallëllë, Hak Dini, V, 3612; Sejjid Kutub, Fi Dhilal, V, 2578.)

Së treti, paraqiten marrëdhëniet e nënshtrimit të atyre robërve të devotshëm me Zotin e tyre në netët e errëta. Stili i të shprehurit në ajet nxjerr në pah qëndrimin në sexhde dhe në këmbë prej namazit, për të përshkruar lëvizjet e robërve të Rrahmanit gjatë një pjese të natës kur njerëzit janë në gjumë. Ata e kalojnë natën duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (në namaz) për Zotin (xh.xh.). Këta njerëz preokupohen me diçka më të dobishme dhe relaksuese sesa gjumi i ëmbël dhe i rehatshëm. Ata janë të zënë duke iu kthyer Zotit të Madhëruar dhe duke lidhur shpirtat dhe gjymtyrët e tyre me Të. Kështu veprojnë ata kur shkojnë në shtëpitë dhe shtretërit e tyre gjatë natës. Uljet dhe ngritjet e tyre janë gjithmonë për Allahun (xh.xh.). Ata i kalojnë netët me takua (devotshmëri), duke medituar madhështinë dheurvejimin e Allahut dhe me frikë nga dënimi i Tij.

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Allahu e mëshiroftë atë që fal namaz nate, që e zgjon edhe gruan e tij dhe që i spërkat ujë në fytyrë nëse nuk zgjohet. Allahu e mëshiroftë edhe gruan që fal namaz nate, që e zgjon edhe burrin e saj dhe që i spërkatë ujë në fytyrë nëse nuk zgjohet!” (Ebu Davud, Vitr 13.)

Amre (k.s.), një nga gratë e devotshme ndaj Zotit, shkante te burri i saj kur zbardhte agimi dhe i thoshte:

“Çohu tashmë!.. Mjaft fjetë!.. Nata ka mbaruar, ka ardhur dita. Yjet e të Lartit kanë filluar të bien në tokë. Karvani i të mirëve është nisur për rrugë.

Kurse ti ende fle. Nuk është e mundur t'i arrish ata në këtë gjendje!” (Enciklopedia e Evliave, I, 219.)

Ndërkohë, ka reflektime nga ndjenjat e thella të devotshmërisë që ata besimtarë, të cilët morën lavdërimin e Zotit të Madhëruar, bartnin në zemrat e tyre duke qëndruar në këmbë dhe në sexhde. Këta robër të devotshëm nuk mbështeten në veprat e tyre, por në mëshirën e pafund të Allahut (xh.xh.). Ndërsa ata qëndrojnë në këmbë dhe pastaj bëjnë sexhde para Zotit (xh.xh.), ndërsa shprehin nënshtrim ndaj të Gjithëmëshirshmit, thonë duke iu mbushur zemrat e tyre me frikën ndaj Allahut dhe xhehenemit: “Zoti ynë! Largoje prej nesh ndëshkimin e xhehenemit! Vërtet, ndëshkimi i tij nuk ka fund dhe është një ndëshkim i tmerrshëm dhe i vështirë për t'u duruar. Me të vërtetë, xhehenemi është një vend i keq dhe një vendbanim i tmerrshëm!” Xhehenemi qëndron sikur është shtruar para të gjithëve, sikur i ka prerë rrugën mbarë njerëzimit, sikur ka shtrirë krahët, sikur ka hapur gojën dhe ka gllabëruar të gjithë afër dhe larg. Edhe robërit e veçantë të Rrahmanit janë të frikësuar dhe dridhen, e lusin Zotin që t'ua mbajë larg këtë ndëshkim dhe t'i shpëtojë nga përballja me këtë ndëshkim dhe vuajtja e tij. Ata nuk e kanë parë xhehenemin, por besojnë në ekzistencën e tij. Ata e kanë xhehenemin në mendjet e tyre siç e përshkruan Kurani Fisnik dhe Profeti (a.s.) dhe kërkojnë strehim te Zoti i Mëshirshëm i botëve nga dënimi i Tij.

Në fakt, ngjarja e mëposhtme që ka ndodhur në epokën e lumturisë (në periudhën e të Dërguarit të Allahut) është shumë mësimdhënëse për të treguar efektin e frikës nga xhehenemi në zemër:

Ishte një i ri nga ensarët. Frika nga xhehenemi ia kishte kapluar zemrën. Ai qante kur përmendej xhehenemi. Në fund, u mbyll në shtëpinë e tij. Kjo situatë iu raportua të Dërguarit të Allahut (a.s.). Pejgamberi shkoi te i riu.

I riu e shikoi të Dërguarin e Allahut (a.s.), me mall, u hodh menjëherë, e përqafoi të Nderuarin e botëve dhe u rrëzua për tokë duke ia dorëzuar shpirtin Zotit (xh.xh.). Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë tha:

“Lajeni dhe qefinoseni vëllain tuaj! Frika nga xhehenemi ia copëtoi mëllçinë. Beto hem në Allahun, në dorën e të Cilit është jeta ime, se Allahu e ruajti atë nga zjarri. Kushdo që dëshiron diçka, kërkon mënyra për ta marrë atë, dhe kush ka frikë nga diçka, ikën prej saj.” (Hakim, el-Mustedrak, II, 536/3828; Ali el-Muttaki, III, 708/8526.)

Drita e mendjes dhe drita e zemrës

— Ali Riza Temel —

Konsiderimi i religjionit (fesë) dhe dijes (shkencës) si dy pole të kundërta që janë armiqësore me njëra-tjetrën është baza e gabimit. Meqenëse Allahu (xh.xh.), është Krijuesi i universit dhe Ai që vendos ligjet natyrore që funksionojnë në univers, është e paimagjinueshme që të ketë ndonjë kontradiktë në këtë sistem që funksionon pa asnjë defekt.

Një mirëkuptim dhe qëndrim në kundërshtim me natyrshmërinë njerëzore në emër të fesë gjithmonë shkakton reagim dhe qëndrim të kundërt. Andaj nuk duhet ta harrojmë faktin se “nëse diçka shkon përtej kufijve të saj, ajo ndryshon në të kundërtën e saj”.

Çdo qëndrim dhe kundërshtim përpiqet të krijojë një terren intelektual dhe filozofik për të gjetur një justifikim për veten e tij dhe ky terren kthehet në një regjim dhe sistem me kalimin e kohës. Regjimet dhe sistemet në kuptimin njerëzor janë gjithmonë të hapura për diskutim, kështu që të gjithë kanë një antitezë.

Sidomos pas lëvizjes perëndimore në vendin tonë, qëndrimi ndaj kishës në perëndim u shfaq edhe kundër islamit, dhe kështu kisha, e cila i shpalli luftë shkencës, u rreshtua me Islamin, urdhërimi i parë i të cilit është «lexo», i cili i ka dhënë përparësi shkencës dhe i cili e ndriçoi perëndimin. Në këtë mënyrë, u mbajt i njëjti qëndrim kundrejt të dyja feve. Është e qartë se një qëndrim i tillë negativ është thelbësisht i gabuar.

Në vendin tonë, i cili ka qenë flamurtar i islamit për një mijë vjet, ky qëndrim dhe botëkuptim kundër fesë duhet të diskutohet dhe arsyet të përcaktohen e analizohen objektivisht dhe brezi ynë të imunizohet kundër këtij virusi.

Ata që mbrojnë ateizmin, thonë se feja përbëhet nga mitologjia dhe legjenda të vjetëruara dhe pretendojnë se feja nuk ka më vend në botën e shkencës, për më tepër, këtë e thonë në emër të shkencës dhe në mënyrë prej dijetari. Fyerja e njerëzve fetarë dhe vlerave fetare është gjithashtu një pjesë e kësaj përpjekjeje.



Në fakt, konsiderimi i fesë dhe shkencës si dy pole të kundërta që janë armiqësore me njëra-tjetrën është baza e gabimit. Meqenëse Allahu është Krijuesi i universit dhe Ai që vendos ligjet natyrore që funksionojnë në univers, është e paimagjinueshme që të ketë ndonjë kontradiktë në këtë sistem që funksionon pa asnjë defekt.

Thelbi i debatit buron vetëm nga pranimi i ekzistencës së botës fizike dhe refuzimi i ekzistencës së botës metafizike. Ndërkohë, fusha e interesit të shkencës pozitive dhe teknikës është e ndryshme nga fusha e interesit të metafizikës dhe teologjisë. Ndërsa e para bazohet vetëm në eksperimente, laboratorë, mendje dhe pesë shqisat, e dyta bazohet në zemrën, ndërgjegjen, dashurinë dhe dhembshurinë. E para përfaqëson materien, e dyta përfaqëson shpirtin dhe përsëritshmërinë. Në kuptimin përfundimtar, nuk është e saktë t'i pranosh ato si plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Ndarja është vetëm në kuptimin kategorik.

I ndjeri Ali Fuat Bashgili (1893-1967), një shkencëtar dhe intelektual i vlefshëm që e njihte historinë e ateizmit dhe shkaqet e shfaqjes së tij, si dhe kishte njohuri islame, në hyrje të veprës së tij me titull Feja dhe Laicizmi, ka përcaktuar qartë kufirin midis fizikës dhe metafizikës. Shkurtimisht është shprehur:

“Le të pranojmë se sot fjala e shkencës është pa dyshim. Nëse mendoj se oksigjeni apo hidrogjeni është më aktiv dhe nëse hezitoj, për këtë pyes

shkencën pozitive. Unë gjithmonë aplikoj te shkencë kur dua të mësoj për fizikën, kiminë, biologjinë dhe astronominë. Përgjigjen që marr gjithashtu e pranoj si të vërtetë. Por unë kurrë nuk pyes shkencën pozitive kur dua të mësoj për Allahun, botën tjetër dhe shpirtin. Këto i mësoj nga Kurani Fisnik dhe hadithi dhe nga komentuesit e muxhtehidët e këtyre që i shpjegojnë këto burime.

Sepse e di që të vërtetat si Allahu (xh.xh.), ahireti dhe shpirti janë jashtë fushës së shkencës pozitive. Fusha e dijes së shkencës janë gjërat që peshohen dhe maten, gjërat materiale që ndjehen me pesë shqisat. Kurse të vërtetat si Allahu dhe shpirti janë të vërteta metafizike që janë të lira nga materia. Pavarësisht kësaj, nëse dikush më flet në emër të shkencës pozitive për Allahun, ahiretin dhe shpirtin dhe thotë se këto janë vërtetuar me metodat e shkencës pozitive, unë e quaj këtë fjalë «iluzion». Nëse një pseudoshkencëtar del dhe më thotë: “E kam peshuar një njeri para dhe pas vdekjes dhe nuk kam vërejtur ndonjë ndryshim në peshën e tij. Atëherë, nuk ka shpirt. Nëse shpirti do të ekzistonte, do të kishte një ndryshim midis dy matjeve.», unë thjesht do të qeshja me këtë pseudoshkencëtar, sepse shpirti nuk është diçka që matet me peshore. Sepse ai është një energji jetësore, ose një forcë jetësore. Gjëra të tilla jomateriale nuk maten me peshore. Këto janë fakte që ekzistojnë natyrshëm në natyrën tonë dhe nuk kanë nevojë për prova. Ashtu si uria tregon ekzistencën e ushqimit dhe etja të ujit, edhe besimi në Zot, i cili gjendet në natyrën tonë, tregon natyrshëm ekzistencën e një qenieje të tillë. Kështu, kur një llambë elektrike peshohet si ndezur edhe fikur, nuk ka asnjë ndryshim në peshë. Megjithatë, ekziston një energji elektrike, një fuqi misterioze që del nga materia.

Nëse një shkencëtar më thotë se nuk mund ta kuptojë ringjalljen pas vdekjes dhe ahiretin, unë i them: A e kupton se si ke ardhur në ekzistencë ndërkohë që nuk ke ekzistuar dhe se nesër do të zhdukesh sërish me vdekjen? Është racionalisht e mundur, madje e nevojshme, të pranosh që poseduesi i pushtetit absolut, që të krijojë ndërkohë që nuk ekzistojë, mund të të krijojë edhe nesër pasi të zhdukesh. Të pranosh njërën nga dy të ngjashmet dhe të refuzosh tjetrën është thjesht kokëfortësi dhe verbëri.

Kurani është fjala e Allahut, si rrjedhojë, në të nuk ka asgjë të kundërt me të vërtetën. Këto të vërteta nuk e humbin realitetin e tyre ngaqë nuk mund të kuptohen prej dikujt.

Ta dish se nuk di është një virtyt, kurse të mos e dish se nuk di është një marrëzi e plotë, domethënë



është injorancë, një injorancë shumëdimensionale. Jo të gjithë i kuptojnë pikëpamjet shumë intelektuale dhe kulturore të filozofëve si Spinoza, Kanti, Bergsoni dhe Blondeli. Por nëse dikush i refuzon këta filozofë ngaqë nuk i kupton, ai njeri quhet thjesht «idiot». Në Kurani Fisnik ka shumë sekrete që duhen vlerësuar sipas njohurive të çdo epoke dhe nivelit të mendjes. Këta mund t'i kuptojnë vetëm ata që janë ekspertë.

Është një fakt i njohur se besimi dhe mbështetja në Allahun i bën njerëzit të fortë dhe të qëndrueshëm përballë fatkeqësive dhe vështirësive. Ateisti nuk ka një fuqi tjetër ku të mbështetet përveçse në disa mjete të kufizuara që posedon. Kur e humb këtë fuqi, bëhet njeriu më i mjerë në këtë botë. Ai në mënyrë të pandërgjegjshme i jepet alkoolit dhe argëtimit ose preferon vetëvrasjen. Nga ana tjetër, besimtari që mbështetet në Allahun, Krijuesin dhe Zotëruesin e çdo gjëje, është gjithmonë i fortë dhe optimist, sepse ai e mbështet shpinën në fuqinë e pathyeshme, jo në atmosferën e errët dhe të tmerrshme të asgjësë, të hiçit dhe të pakuptimisë. Ai gjithmonë përjeton lumturinë e ekzistencës, pavdekësisë dhe lumturisë së përjetshme. Këto që thamë janë për besimtarët e vërtetë dhe të përsosur. Dihet se myslimanët me emër nuk mund ta arrijnë këtë kënaqësi.”

Asnjë mbret nuk e zotëron dot mbretërimin shpirtëror si njerëzit e mëdhenj Junusi, Mevlana, Bejazidi Bistami dhe Ibrahim ibn Edhemi.

Me cilat mundësi materiale mund të fitohet kënaqësia e besimit dhe prehja shpirtërore e Junusit i cili e shpreh pavdekësinë e shpirtit duke thënë: «Nëse vdes, vdes trupi. Kurse shpirti është i pavdekshëm.»

Dija është drita e mendjes, kurse besimi është drita e zemrës. T'i fikësh këto drita do të thotë të mbetesh i dënuar në errësirë. Ne si besimtarë aspirojmë të jetojmë në dritën e mendjes dhe diturisë, zemrës dhe besimit. **“A është njëlloj i verbri me atë që shikon? Apo, a është njëlloj errësira dhe drita?”** (Ra’d, 16)

Allahu i Lartësuar na nxjerrtë nga errësira e mohimit drejt dritës së besimit duke na shpëtuar nga verbëria e syve dhe e zemrave! Amin!

Devotshmëria dhe frika ndaj Allahut, që gjendeshin në gjuhën dhe veshët e tij, zinin një vend më të madh se bota dhe më të gjallë se jeta në zemrën e Muhasibiut. Zemra e Muhasibiut ishte e zbrazët nga të gjitha llojet e shqetësimeve, si zemra e një njeriu që jeton me vetëdijen se mes tij dhe varrit ka mbetur kohë vetëm një moment.



Një dijetar me zemër të zbrazët nga çdo shqetësim

— Ajdin Bashar —

Këto dy fjalë, devotshmëria dhe frika ndaj Allahut, që gjendeshin gjithmonë në gjuhën dhe veshët e Muhasibiut, zinin një vend më të madh se e gjithë bota dhe më të gjallë se vetë jeta në zemrën e Muhasibiut. Zemra e Muhasibiut ishte e zbrazët nga të gjitha llojet e shqetësimeve, si zemra e një njeriu që jeton me vetëdijen se mes tij dhe varrit ka mbetur vetëm një moment. Prandaj, ai i paralajmëroi njerëzit me gjuhën dhe shkrimet e tij sikur të kishte parë xhenetin dhe mirësitë e tij, xhehenemin dhe ndëshkimin e tij.

Imam Ebu Abdullah el-Harith ibn Esed el-Muhasibiu lindi në Basra rreth vitit 165 hixhri, jetoi në Bagdad, mori mësim nga Imam Shafiu, mbrojti Ehli Sunetin kundër rafizive, mutezilive dhe atyre që mohonin kaderin dhe ishte një dijetar i njohur kryesisht për aspektet e tij mistike. Ai konsiderohet të jetë një ndër dijetarët e parë të mëdhenj si Ibrahim ibn Edhemi, Davud et-Tai, Fudajl ibn Ijazi, Ma'ruf el-Kerhi, Bishr el-Hafiu, Dhunnun el-Misri, Abdullah et-Tusteri dhe Xhunejd el-Bagdadi. Imam Shatibiu ka thënë në lidhje me këtë çështje: “Muhasibiu është njëri prej dijetarëve të mëdhenj që mund të ndiqet dhe të merret si shembull.» (Shatibi, el-I'tisam, I/284)

Ai ka shkruar shumë vepra mbi tema të tilla si

gjendjet e nefsit, pastrimi dhe mangësitë e tij, llogaritja e nefsit, natyra e mendjes dhe të kuptuarit e Kuranit. Dihet se Imam Gazaliu ka përfitur nga veprat e tij mistike. Një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të mendimit asketik të adoptuar nga Muhasibiu në shekullin e parë është Hasan el-Basriu, një dijetar nga tabiinët. Një nga sahabët prej të cilit u frymëzua më shumë Hasan el-Basriu, i cili u takua me njëqind e njëzet sahabë, ishte Enes ibn Maliku, radijall-llahu anh, i cili i kishte shërbyer Pejgamberit (a.s.). Kur të ndjekim këtë dhe hallka të ngjashme frymëzimi, të cilat janë përcjellë nga shekulli në shekull, arrijmë tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Kështu sqarohet edhe çështja se ku bazohet mistika islame.

Muhasibiu ka edhe vepra rreth shkencës së Kelamit që i ka shkruar për të hedhur poshtë pikëpamjet e sekteve që nuk janë në përputhje me Ehli Sunetin. Ahmed ibn Hanbeli e ka kritikuar atë ngaqë është bërë shkak për përhapjen e mendimeve të Mutezilesë duke i shpjeguar ato gjerë e gjatë ndërsa i kritikonte. Sipas një transmetimi në Tabakatu'l-Kubra të Sharanit, Ahmed ibn Hanbeli një natë kishte marrë pjesë në bisedën fetare të Muhasibiut dhe më pas ishte penduar për ato që kishte thënë për sufite (mistikët). Mirëpo, ka edhe dijetarë që thonë se ky transmetim është i diskutueshëm.

Burimet përfshijnë informacionin e mëposhtëm në lidhje me pjesëmarrjen e Ahmed ibn Hanbelit në bisedën fetare të Muhasibiut dhe raportimin e asaj që ai pa: «Kur u thirr ezani i akshamit, ai kaloi përpara dhe fali namazin si imam. Pas faljes së namazit erdhi ushqimi. U ulën për të ngrënë. Harith El-Muhasibiu edhe fliste, edhe hante. Faktikisht është në përputhje me sunetin që të flitet për gjëra të mira gjatë ngrënies. Pasi hëngrën, lanë duart. Pastaj u ulën së bashku. Kur të gjithë u ulën në vendet e tyre, ai pyeti: «A ka dikush ndonjë pyetje?» Ata bënë pyetje rreth shtirjes, sinqeritetit dhe temave të tjera. Ai iu përgjigj pyetjeve. Përveç të tjerash, dha edhe argumentet e tij. Ai qante, rënkonte dhe derdhte lot ndërsa lexohej Kurani Fisnik. Kur mbaroi leximi i Kuranit, Harith el-Muhasibiu bëri një lutje me zë të lehtë dhe më pas u ngrit për të falur namazin. Kur erdhi mëngjesi, Ahmed ibn Hanbeli tha se Harith el-Muhasibiu ishte një njeri i virtytshëm dhe kështu shprehu vlerësimin e tij për të.» (Prof. Dr. Abdulaziz Hatip, Farzet ki Öldün - Supozo se ke vdekur, Pjesa e Hyrjes, fq. 24.)

Njëra nga temat që ai e thekson më shumë në jetën e tij është çështja e të ardhurave hallall. Në një video të Doç. Dr. Mahmut Aj kam hasur në materialin e mëposhtëm: Sipas një transmetimi, Muhasibiu një ditë po bënte pehriz në gjendje urie. Kur një i njohur e pa atë të zverdhej nga uria, i tha: «Shkojmë në shtëpinë tonë dhe unë do t'ju shërbej ushqim.» Harith el-Muhasibiu i tha: “Mirë bir.”, dhe shkuan së bashku në shtëpinë e tij. Atij iu servir një ushqim dasme. Pasi mori një kafshatë ushqimi në gojë, ai e lëvizte atë shumë herë nëpër gojë, por nuk e gëlltiste dot. Ai doli jashtë dhe e nxori atë kafshatën në një vend të përshtatshëm. Pastaj u largua prej andej. Personi që i dha ushqim e pyeti atë disa ditë më vonë: «Cila ishte urtësia që vepruat kështu?» Muhasibiu iu përgjigj: “Desha të të fitoja zemrën duke ngrënë ushqim në shtëpinë tënde. Por ka një shenjë mes nesh dhe Zotit. Unë i jam lutur Allahut që të mos kalojë në fytyrën tim as gjëja më e vogël haram. Si i tillë, nuk ishte e mundur ta gëlltisja atë ushqim.”

Më pas ai e pyeti atë se nga i kishte ardhur ushqimi. Ai iu përgjigj se i kishte ardhur nga dasma e një të afërmi.

Ai e ftoi edhe një herë atë për ushqim. Së bashku shkuan në shtëpi. Këtë herë atij i shërbeu bukë të thatë. Atë e hëngri me kënaqësi dhe i tha: “Kur t'i ofrosh ushqim një besimtar, ofroji kështu nga hallalli. Le të jetë bukë e thatë, por le të jetë hallall.” Siç mund të kuptohet nga kjo histori, Muhasibiu

ishte shumë i ndjeshëm ndaj rrëskut hallall. Ai ka një vepër për këtë çështje të titulluar «El-Mekasib» i përkthyer si «Rrësku Hallall».

Muhasibiu, siç folëm edhe më sipër, flet për proceset që do t'i ndodhin njeriut pasi të futet në varr, në librin e tij me titull "*Supozo se ke vdekur*". Ai preferon të japë këshilla më shumë sesa të japë informacion ose të diskutojë një temë sipas një metode. Në kapitujt e parë të librit, Muhasibiu, i cili flet për tablotë e dhimbshme në varr dhe tablotë e tmerrshme në xhehenem, me një stil shumë të sinqertë dhe të dëlirë e fton lexuesin që të largohet nga shkujdesja. Për shembull, kur përshkruan apokalipsin (kiametin), ka përdorur një shprehje të tillë: “Mendo për atë moment kur fëmijët e tu, babai, vëllezërit e motrat, bashkëshorti/ja dhe të afërmit e tu ikin prej teje dhe ti të largohesh prej të gjithëve për shkak të asaj frike, dridhjeje, tmerrri, vetmie dhe hutimi.” Kur përshkruan Siratin, pothuajse e bën lexuesin të dridhet nga frika duke thënë: “Mendo për kalimin në urën e Siratit me gjithë atë frikë të madhe dhe trupin tënd të dobët.”

Abdulfettah Ebu Gudde flet për këtë aspekt të tij siç vijon:

“Harith el-Muhasibiu ka qenë i pajisur me devotshmëri dhe frikë ndaj Allahut, me sinqeritet të madh, me një zemër rrezatuese dhe një aftësi të efektshme elokucence. Këto dy fjalë, devotshmëria dhe frika ndaj Allahut, që gjendeshin në gjuhën dhe veshët e tij, zinin një vend më të madh se bota dhe më të gjallë se jeta në zemrën e Muhasibiut. Zemra e Muhasibiut ishte e zbrazët nga të gjitha llojet e shqetësimeve, si zemra e një njeriu që jeton me vetëdijen se mes tij dhe varrit ka mbetur kohë vetëm një moment. Për këtë arsye, i paralajmëronte njerëzit me gjuhën dhe shkrimet e tij sikur ta kishte parë xhenetin e mirësitë e tij dhe xhehenemin e ndëshkimit të tij. Ishte pothuajse si njerëzit që synonte Malik ibn Dinari në fjalët e tij: «Do të doja të gjeja ndihmës dhe t'i dërgoja nëpër botë duke thirrur: O njerëz! Xhehenemi ekziston! Xhehenemi ekziston!» (Udhëzues për kërkuesit e së vërtetës, fq. 30.)

Në pjesët e mëvonshme të veprës, Muhasibi përshkruan bukuritë e parajsës dhe përshkruan begatitë, pallatet dhe sarajet atje me një gjuhë pothuajse si mjaltë. Ai flet për lumenjtë e xhenetit, kopshtet e fitores, hijen Tuba, bisedat e ëmbla, kodrat e misikut, aromat e këndshme dhe shumë mirësi të tjera të xhenetit. Zoti na e mundësoftë të gjithëve që t'i arrijmë ato mirësi!



Shembulli i asqetizmit, dashurisë dhe qëndrueshmërisë

IMAM AHMED IBN HANBELI (R.A.)

BEGATIA E HADITHIT FISNIK

Ahmed ibn Hanbeli i cili ishte një prej muhadithëve dhe fakihëve të mëdhenj që ka nxjerrë civilizimi Islam dhe i katërti i imamllarëve të medhhebeve, në të njëjtën kohë ishte i njohur edhe me fjalët e tij të urta, koncize dhe të mençura. Ngaqë ia dedikoi jetën fjalëve të bekuara të të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe jetoi sipas atyre rregullave, edhe fjalët e tij fituan vlera të mëdha.

Ja disa prej atyre këshillave:

“Për njeriun është e mjaftueshme pak pasuri. Ndërsa pasuria e shumtë nuk i mjafton.”

“Tevekkul do të thotë t’i dorëzohesh Allahut në të gjitha punët e tua, të pranosh se çdo gjë që të ndodh të vjen prej Tij dhe të durosh.”

“Nuk ka gjë më të dobishme për njeriun më shumë sesa të qëndrojnë bashkë me të devotshmit, në mënyrë që ta rregullojë zemrën dhe të arrijë begatinë e prehjen shpirtërore.

Nga ana tjetër, nuk ka gjë më të dëmshme për njeriun sesa të qëndrojnë me mëkatarët dhe t’i shikojë me dëshirë punët që bëjnë ata.” (Të menduarit e

njëjtë sjellë në pah bashkimin shpirtëror.)

“Nëse një njeri privohet nga një shok i sinqertë, kjo është një humbje e madhe për të.”

“Ata që kërkojnë shokë pa gabime, mbesin pa shokë.”

“Një shok që nxehet, preket dhe zemërohet kur nuk ia jep ato që kërkon, nuk është shok i vërtetë.”

“Ushqimin duhet ta hamë me kënaqësi me vëllëzërit në fe, me bujari me të varfrit dhe me dinjitet me njerëzit e tjerë.”

“Mirësitë që i konsideroni të vlefshme përpiquni t’i bëni para se t’ju dalë ndonjë pengesë.”

“Sinqeriteti është shpëtim nga fatkeqësitë e veprave.”

“Jeta e njeriut që mendon mirë kalon për së mbari.”

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Për njeriun është e mjaftueshme pak pasuri. Ndërsa pasuria e shumtë nuk i mjafton.”

“Mëkatet e dobësojnë besimin.”

“Gënjeshtria e shkatërron besueshmërinë.”





“Për çdo gjë ka fisnikëri. Fisnikëria e zembrës është që të jetë e kënaqur prej Krijuesit dhe ta pranojë kaderin.”

“Në një kokë që mbart mendjemadhësi, nuk mund të gjeni mendje.”

“Klasa më idiote e njerëzve janë ata që u pëlqen të lavdërohen nga të tjerët.”

“Dija është e dobishme për njerëzit aq sa buka dhe uji.

Dija nuk është vetëm transmetim, informacione të thata dhe barrë informacioni i akumuluar në mendje.

Dija është çdo gjë e dobishme dhe me të cilën punohet.

(Dija që nuk reflektohet në praktikë është një dije e padobishme siç shprehet edhe i Dërguari i Allahut (a.s.).”

“Merita arrihet vetëm me një virtyt, dije dhe urtësi të plotë.”

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Tevekkul do të thotë t’i dorëzohesh Allahut në të gjitha punët e tua, të pranosh se çdo gjë që të ndodh të vjen prej Tij dhe të durosh.”

Kur Ali el-Medini, i cili ishte prej dijetarëve të asaj periudhe, i kërkoi Ahmed ibn Hanbelit (r.a.), që ta këshillonte, Ahmed ibn Hanbeli i tha këto fjalë që i kishte rregull të jetës së tij:

USHQIMI YT LE TË JETË DEVOTSHMËRIA!

“Ushqimi yt le të jetë devotshmëria dhe botën tjetër le ta kesh gjithmonë parasysht!”

Ahmed ibn Hanbeli, rahmetull-llahi alejhi, pati mbetur jetim që në moshë shumë të vogël. Me mësimin dhe edukimin e tij u interesua nëna e vet. Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), e filloi marrjen e dijes që në moshë të vogël. Ai mori mësim në shumë fusha duke filluar që nga hadithi e leximi i Kuranit dhe u edukua në Bagdad, në qytetin ku gjendeshin shumë dijetarë dhe figura të mëdha të tasavvufit.

Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), nuk u mjaftua me dijetarët e këtij qyteti dhe shëtiti në shumë vende të Islamit me dashurinë për të mësuar përmendësh hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe mallëngjimin për të marrë dije. Ai u përballua më vështirësi të mëdha përgjatë këtij procesi. Për shkak se nuk kishte kafshë transporti, trastat e librave i mbartte në kurriz përgjatë këtyre udhëtimeve.

Ndërsa përgjatë udhëtimit të dijes që bëri drejt Jemenit për të përfutur nga dijetari i hadithit Abdurrezzak ibn Hemmami, u detyrua t’u bënte roje deveve të karvanit ngaqë nuk kishte para të mjaftueshme.

Ai duronte kundrejt të gjitha këtyre mundimeve dhe vështirësive duke e pritur shpërblimin nga Allahu (xh.xh.).


Një herë e pa dikush që e njihte. Kur ky person i pa shënimet e shumta që kishte shkruar dhe hadithet fisnike që i kishte mësuar përmendësh, e pyeti: “Një herë shkon në Kufe, një herë tjetër shkon në Basra! Deri kur do të vazhdosh kështu?” Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), i dha këtë

përgjigje që tregonte se ai e kishte bërë parim për veten principin e Islamit për ta mësuar dijen nga djepi deri në varr:

“ME PENDË DHE ME BOJË DERI NË VARR...”

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Nuk ka gjë më të dobishme për njeriun më shumë sesa të qëndroj bashkë me të devotshmit, në mënyrë që ta rregullojë zemrën dhe të arrijë begatinë e prehjen shpirtërore.”

Me të vërtetë, edhe pse Ahmed ibn Hanbeli mori dije deri në moshën dyzet vjeçare, e vazhdoi preokupimin me dijen duke u dhënë të tjerëve mësim të hadithit fisnik. Ndërkohë që me gjendjen e tij shfaqte edukatën dhe moralin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), me gjuhën u transmetonte nxënësve



ASKETIZMI DHE TEVEKKULI I TIJ ISHTE LARG RRUGËS QË NDJEKIN TË SHKRETËT QË E LËNË PUNËN NË KËTË BOTË DHE U SHTRIJNË DORËN NJERËZVE, SEPSE ASKETIZMI I VËRTETË NUK ËSHTË PRIVIMI NGA PASURIA, POR QË PASURIA TË MOS SUNDOJË ZEMRËN.

të tij hadithet e Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë, të cilat arrinin numrin pesë mijë.

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Nëse dikush privohet nga një shok i sinqertë, kjo është një humbje e madhe për të.”

Dikush prej nxënësve e frekuentonte mexhllisin e tij për të përfituar nga dija e imamit. Ndërsa dikush tjetër e frekuentonte për të marrë nga gjendja e tij. Siç shprehet njëri prej nxënësve të tij, në mexhlliset e dijes së imamit ndjehej kënaqësia e botës tjetër. Kjo përshpirtshmëri ishte rezultat i sinqeritetit dhe devotshmërisë së imamit të madh.

Sa rob i devotshëm që ishte Imam Ahmedi i cili nuk e la asnjëherë ibadetin e natës, i cili e bëri zakon të lexonte një të shtatën e Kuranit Fisnik çdo ditë, i cili mori pjesë nëpër luftëra dhe bëri rojë përgjatë kufijve për një kohë të caktuar, në mënyrë që të mos privohej nga sevapi i xhihadit dhe i cili e kurorëzoi dijen e tij me vepër dhe veprën e tij me sinqeritet!

Shpesh herë shkonte te evliaja i madh, Bishr el-Hafiu dhe bisedonte me të. Ai ishte i lidhur me të me plot kuptimin e fjalës. Një herë nxënësit i thanë:

“O Imam! Ti je një dijetar muxhtehid në shkencat e Kuranit dhe Sunetit. Krahas kësaj, cila është urtësia që shkon shpesh te ai njeri i zakonshëm?”

Imami i madh u dha këtë përgjigje:

“Po, gjërat që i përmendët unë i di më mirë se ai, por ai e njeh më mirë se unë Allahun e Lartësuar. Domethënë, ka marrë më shumë pjesë se unë nga “marifetull-llahu / njohja e Allahut”...”

Për disa çështje që nuk mund t'i zgjidhte shkonte dhe pyeste Maruf el-Kerhin i cili ishte prej miqve të Allahut. Kur e pyetën për shkakun e kësaj, dha si shembull këtë ngjarje që ka ndodhur ndërmjet

Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë dhe sahabëve:

Sahabët e nderuar e pyetën të Dërguarin e Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Çfarë të bëjmë nëse nuk e gjejmë dot në Kuran dhe Sunet çështjen për të cilën kërkojmë?”

Pejgamberi iu përgjigj:

“*Pyetni njerëzit e devotshëm dhe konsultohuni me ata për atë!*”

Edhe Ahmed ibn Hanbeli, ashtu si imamllarët e tjerë të medhhebeve tona, i ka vlerësuar njerëzit e devotshëm dhe ka pirë nga keutheri i përshpirtshmërisë së tyre derisa është ngopur.

Në këtë mënyrë, falë pastrimit dhe dëlirjes shpirtërore, cilësitë e tij morale u bënë më të kulluara, të sinqerta dhe të buta.

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Shoku i cili nxehet, preket apo zemërohet kur nuk ia jepni ato që dëshiron, nuk është shok i vërtetë.”

Prej shumë cilësive etike të tij vlen të përmenden të mjaftuarit me atë që ka dhënë Zoti dhe mbështetja te Zoti (xh.xh.).



HEROI I ASKETIZMIT DHE VARFËRISË

Zemrën e kishte të pasur me thesarin e mjaftueshmërisë me atë që ka dhënë Zoti, por materialisht ishte i varfër. Për shkak se nuk i mjaftonin për jetesë para e qirasë që merrte nga tezgjahu i thurjes të cilin e kishte trashëgimi nga i ati, nganjëherë shumonte libra me pagesë, nganjëherë bënte rripa dhe nganjëherë tjetër shiste copën që e thurte bashkëshortja e tij. Nganjëherë ndodhte që të mblidhte bashkë me nevojtarët e tjerë mbetjet nëpër ara pasi korreshin të mbjellat. Kur nuk gjendej gjë për të ngrënë e për të pirë në shtëpinë e tij, gëzohej në vend që të mërzhitej. Pastaj i lagte thërrimet e bukës, u hidhte pak kripë dhe i hante. Për atë pak gjë që hante, thoshte:

“Edhe këto janë shumë për udhëtarët e jetës së përkohshme.” Ai nuk i lavdëronte ushqimet e shtrenjta. Kur i jepnin prej tyre, ose i shijonte pak, ose nuk hante fare prej tyre.

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Ushqimin duhet ta hamë me kënaqësi me vëllezërit në fe, me bujari me të varfrit dhe me dinjitet me njerëzit e tjerë.”

Shkaku shpirtëror që ai përpiquej për t’u mjaftuar me aq sa i duhej nefsit në jetën ditore ishte që ta bënte zemrën me fletë duke e frenuar trupin.

Sepse njeriu merr ndikime të mëdha nga ato që ha, ato që pi dhe nga shoku i tij.

Një njeri evlia i cili quhej Ebu Hafs Omer ibn Salih Tarsusi, i bëri këtë pyetje Ahmed ibn Hanbelit:

“Me çfarë zbuten zemrat?”

Imami e uli kokën dhe pasi mendoi pak iu përgjigj:

“Bir! Zemrat zbuten me ushqim hallall.”

Ahmed ibn Hanbeli krahas asketizmit dhe të mjaftuarit me atë që i kishte dhënë Zoti, ishte i pasqor edhe për sa i përkiste zemrës së ngopur dhe tevekkulit, domethënë për sa i përkiste mbështetjes vetëm te Allahu pa ia shtrirë dorën askujt. Imami nuk i pranonte jo vetëm propozimet e udhëheqësve, por edhe të hoxhallarëve dhe të atyre që e donin. Ai mjaftohej me disa kafshata që i fitonte më djersën e ballit. Birit të tij i cili e qortoi duke i thënë se i kishte refuzuar dhuratat e shumë dijetarëve, i lexoi këtë ajet fisnik:

“...Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm.” (Taha, 131)

Imam Ahmedi, i cili ishte shumë i përpiktë për të mos i nënshtruar mirësitë e kësaj bote ndaj dëshirave të nefsit, edhe pse ishte shumë i kujdesshëm

në çështjen e asketizmit dhe devotshmërisë, jetonte në modesti dhe thjeshtësi. Ai i kujtonte shpesh virtytet e të mëdhenjve të Islamit para tij dhe ankohej duke thënë:

“Ku ishin ata, ku jemi ne!..”

Ai priste mysafirë në shtëpinë e tij në të cilën nuk gjendej gjë tjetër përveç një hasre të vjetër dhe disa tasave e tenxhereve. Ata i nderonte me bukë të thatë ngaqë nuk mund të bënte asgjë më shumë dhe i respektonte me sjellje të larta. Kur i vinin në dorë tre-pesë dërhëmë, menjëherë ua jepte të afërmve nevojtarë apo atyre që i kërkonin ndihmë.

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Mirësitë që i konsideroni të vlefshme përpiquini t’i bëni para se t’ju dalë ndonjë pengesë. Singëriteti është të shpëtuarit nga fatkeqësitë e veprave.”

Ahmed ibn Hanbeli siç jetonte me asketizëm dhe varfëri në jetën materiale, ashtu jetonte edhe në jetën shpirtërore.

ÇFARË ËSHTË ASKETIZMI?

Kur u pyet:

“Çfarë është asketizmi?”, ai u përgjigj:

“Asketizmi është tre llojesh:

I pari: Asketizmi i popullit injorant që përbëhet nga lënia e haramëve.

I dyti: Asketizmi i dijetarëve. Ky përbëhet nga largimi prej tepicës së hallalleve. Përdorimi i tyre sa më pak të jetë i mundur, domethënë vetëm sa të kenë nevojë.

I treti: Asketizmi i të urtëve. Ky përbëhet nga lënia e çdo gjëje që të bën të harrosh Allahun Teala.”

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Jeta e njeriut që mendon mirë, kalon mirë.” “Mëkatet e dobësojnë besimin.”

Asketizmi dhe tevekkuli i tij ishte larg rrugës që ndjekin të shkretët që e lënë punën në këtë botë dhe u shtrijnë dorën njerëzve, sepse asketizmi i vërtetë nuk është privimi nga pasuria, por që pasuria të mos sundojë zemrën.

Një ditë Imami u pyet:

“A pasuria apo varfëria është më e virtutshme?” Ai u përgjigj kështu:

“Bëj tregti në pazar dhe mos ua shtri dorën njerëzve. Nuk di se ka virtyt më të madh sesa të mos ua shtrish dorën njerëzve.”

Edhe një cilësi tjetër dalluese e Imam Ahmed ibn Hanbelit, i cili nuk ua shtrinte dorën njerëzve

dhe i cili ia shprehte nevojat e veta vetëm Allahut, ishte dashuria e veçantë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), me hadithet fisnike të të cilit preokupohej.

SHËRIMI I TEBERRUKUT

Dashuria që ndjente ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), e bëri Ahmed ibn Hanbelin një prej dijetarëve të mëdhenj të hadithit prej paraardhësve të devotshëm. Gjithashtu u bë shkak që të linte vepra shumë të vlefshme në këtë fushë.

Sa mësimdhënës që janë këta shembuj teberrukut (begatie) që reflektojnë dashurinë që ai kishte ndaj Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë (a.s.):

Tregon biri i Ahmed ibn Hanbelit (r.a.), Abdullahu:

“Babai merrte një fije prej flokëve të Resulullahut (a.s.), e vendoste mbi buzë dhe e puthte. Babanë e kam parë duke e vendosur edhe mbi sy fijen e flokëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ai e fuste në ujë fijen e flokut të Resulullahut (a.s.) dhe pastaj e pinte atë ujë. Me këtë ujë (begatinë e tij) kërkonte shërim nga Allahu Teala.

Një ditë babai mori tasin në të cilin pinte ujë Resulullahu (a.s.). Pastaj e lau atë në një enë të gjerë dhe piu nga ai ujë.

Përsëri ai pinte nga uji i zemzemit me nijetin e shërimit dhe me të lagte duart dhe fytyrën.” (Dhehebi, Sijeru A’lami’n-Nubela, Bejrut 1986-1988, XI, 212.)

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Për çdo gjë ka fisnikëri. Fisnikëria e zemrës është që ajo të jetë e kënaqur nga Krijuesi dhe të pranojë kaderin.”

Lidhja shpirtërore e Imam Ahmed ibn Hanbelit me të Dërguarin e Allahut (a.s.), arriti deri në atë masë sa që transmetohet se tri hadithe fisnike i ka marrë në ëndërr nga vetë Resulullahu, (a.s.).

Kjo dashuria e madhe i ngarkoi atij një detyrë:

VUAJTJA PËR MBROJTJEN E BESIMIT

“Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), ka thënë: “Në një kokë që mbart mendjemadhësi, nuk mund të gjeni mendje.” “Klasa më idiote e njerëzve janë ata që u pëlqen të lavdërohen nga të tjerët.”

Për shkak të situatave jashtëzakonisht kritike si preokupimi i tepërt me filozofinë dhe lartësimi i mendjes mbi revelatën hyjnore, u shfaqën disa fraksione të devijuara në botën islame të cilat dolën jashtë rrugës së ehli sunet ve’l-xhematit.

Mutezileja, e cila ishte njëra prej këtyre, në periudhën e Ahmed ibn Hanbelit mori nën ndikim kalifët abbasitë.

Udhëheqësit e helmuar me mendime të devijuara

filluan t’i merrnin në hetim me imponim të gjithë dijetarët dhe t’ua impononin mendimet e tyre duke përdorur fuqinë e pushtetit. Shumë dijetarë i pranuan formalisht mendimet e atyre për të shpëtuar nga padrejtësia dhe presioni përgjatë këtyre ngjarjeve që në historinë islame u quajtën “mihne”. Ndërsa Imam Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), tha të drejtën dhe shprehu bindjen që kishte në zemër.

Fillimin e kësaj ngjarjeje e tregon si më poshtë Rabi ibn Sulejmani, i cili ishte prej nxënësve të Imam Shafiut:

Një ditë Imam Shafiu më tha:

“Rabi! Merre këtë letër dhe çoja Ahmed ibn Hanbelit! Pastaj më sill përgjigjen e tij!”

Edhe unë e mora letrën dhe shkova në Bagdad. Në namazin e mëngjesit u takova me Imam Ahmed ibn Hanbelin (r.a.). Namazin e mëngjesit e fala pas tij.

Pasi Imam Ahmedi u largua nga mihrabi, iu afrova, i dhashë letrën dhe i thashë:

“Kjo është një letër që ua ka dërguar vëllai juaj nga Egjipti, Imam Shafiu.”

Ai më pyeti nëse e dija se çfarë përmbante letra. Unë i thashë se nuk dija gjë. Pas kësaj Ahmed ibn Hanbeli e hoqi vulën mbi letër dhe filloi ta lexonte. Papritur sytë iu mbushën me lot. Unë i thashë:

“O Imam! Qoftë për mirë, inshallah! Çfarë shkruan në letër?”

Filloi të më tregonte:

“Imam Shafiu paska parë në ëndërr Pejgamberin (a.s.). I Dërguari i Allahut i paska thënë:

“Shkruaji një letër Ahmed ibn Hanbelit dhe jepi salam edhe prej meje. Me të vërtetë ai do të përballet me një fitne të madhe dhe do t’i kërkohet të thotë se Kurani është i krijuar. Kurrë të mos i bindet kësaj kërkesë! Allahu do ta bëjë emrin e tij të përmendet deri në kiamet dhe do ta lartësojë.”

“Ahmed ibn Hanbeli ka thënë: “Dija është e dobishme për njerëzit aq sa buka dhe uji. Dija nuk është vetëm transmetim, informacione të thata dhe barrë informacioni i akumuluar në mendje. Dija është çdo gjë e dobishme dhe me të cilën punohet.”

Unë i thashë:

“O Imam! Sa përgëzim i madh që është ky për ty!”

Nisur nga kjo, Imam Ahmedi e hoqi këmishën nga gëzimi dhe ma dha mua.

Pasi mora letrën me përgjigjen e Ahmed ibn Hanbelit, u ktheva në Egjipt.

Letrën ia dhashë Imam Shafiut.

Nisur nga kjo Imam Shafiu më tha:

“Nuk dua të të mërzis duke ta marrë atë këmishë që ta ka bërë dhuratë. Por të paktën fute atë në ujë dhe ma jep mua atë ujë, në mënyrë që edhe unë të bëhem ortak me ty në begatinë e asaj këmishë.”

Ja solidariteti dhe dashuria që kishin ndaj njëritjetrit dijetarët e singertë dhe të devotshëm...

Ja lidhja e tyre me dashuri ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.)...

“Dikush i bëri këtë pyetje Ahmed ibn Hanbelit: “Me çfarë zbuten zemrat?” Imam uli kokën dhe pasi mendoj pak, i tha: “Bir! Zemrat zbuten me ushqim hallall.”

Ëndrra u realizua. Imam Ahmed, si shumë dijetarë të tjerë, u imponua për të thënë se “Kelamu’ll-llah / Kurani” është i krijuar.

Shumë prej tyre shpëtuan nga përndjekja duke bërë komentime të ndryshme.

Por Imam Ahmed ibn Hanbeli, siç shprehet “miku i Zotit” Bishr el-Hafiu, shfaqti një durim prej pejgamberi dhe doli si flori i pastër nga zjarri në të cilin u hodh.

DURIMI PREJ PEJGAMBERI

Ai nuk bëri lëshime prej atyre që besonte. Për shkak të kësaj u rrah me kërbac për ditë të tëra dhe me pranga në duar e bënë të ecte nga Bagdadi deri në Tartus. U burgos njëzet e tetë muaj. Pastaj u mbajt nën vëzhgim. U ndalua që të jepte mësim dhe t’u mësonte hadithe të tjerëve...

Ai duroi kundrejt të gjitha këtyre torturave për ta mbrojtur fisnikërinë e Islamit dhe nderin e dijes kundrejt fuqisë së arrogancës.

Edhe kjo është një e vërtetë se;

Kontradiktat që përjetuan katër imamllarët e medhhebeve tona me qeveritë e atyre periudhave dhe vuajtjet që hoqën prej tyre, ishte që feja jonë sublime të mbartej në kohët e ardhshme siç e ka lënë amanet i Dërguari i Allahut (a.s.).

Po ta kishte ulur kokën Ahmed ibn Hanbeli si të shkujdesurit, Allahu na ruajt, do të dobësohej besimi i ehli sunetit dhe të gjitha mendimet e një fraksioni të devijuar që pati ndikuar te udhëheqësit zullumqarë, hap pas hapi do të bëheshin zyrtarë.

Ahmed ibn Hanbeli (r.a.), i hoqi këto vuajtje, por u bë përkthyesi i ndjenjave të umetit. Ai i çliroi zemrat me qëndrueshmërinë dhe trimërinë e tij. Edhe pse vetë nuk donte aspak, fama e tij u përhap në të gjithë botën islame. Ai i mposhti i vetëm të

gjithë zullumqarët.

“Imam Ahmed, si shumë dijetarë të tjerë, u imponua për të thënë se “Kelamu’ll-llah / Kurani” është i krijuar, por ai nuk bëri lëshime prej atyre që besonte. Për shkak të kësaj u rrah me kërbac për ditë të tëra, u syrgjynos dhe u burgos. Kështu shfaqti sublimitetin e Islamit.”

Ai e konsideronte edhe famën si një fatkeqësi dhe me personalitetin modest që kishte, thoshte se dëshironte të jetonte pa u njohur në njërin nga lagjet e Mekës.

Por për shkak të dashurisë që kishte ndaj Allahut dhe të Dashurit të Tij, Zoti e bëri atë të dashur të robërit e Vet.

Aq sa kur ndërroi jetë, xhenazja e tij u bë dëshmitare e kësaj dashurie të jashtëzakonshme:

XHENAZJA QË U BË SHKAK PËR UDHËZIM

Njerëzit u dyndën si rrëkeja edhe nga krahinat e tjera përreth Bagdadit për të falur namazin e xhenazes së Ahmed ibn Hanbelit. Në namazin e xhenazes së tij morën pjesë me mijëra besimtarë.

“Tregon biri i Ahmed ibn Hanbelit: “Babai merrte një fije prej flokëve të Resulullahut (a.s.), e vendoste mbi buzë dhe e puthte. Babanë e kam parë duke e vendosur edhe mbi sy fijen e flokëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.).”

Atë ditë shumë njerëz prej çifutëve dhe të krisherëve në qytet u bënë myslimanë duke parë përcjelljen madhështore të kësaj xhenazeje.

Bijtë e vet që i edukoi, mbajtën gjallë Musnedin dhe medhhebin e tij.

Hanbelizmi, i cili është njëri prej katër medhhebeve të vërteta që akoma ekzistojnë dhe që kanë pasues, është formuar rreth mendimeve të Ahmed ibn Hanbelit (r.a.).

Jeta edhe e këtij dijetari të madh, i cili ishte monument i asketizmit, devotshmërisë, mjaftueshmërisë me atë që ka dhënë Zoti, qëndrueshmërisë dhe dashurisë, kaloi me shërbime fetare të natyrës sadakatun xharije - lëmoshë rrjedhëse në dije dhe urtësi.

Allahu i Lartësuar na bëftë prej robërve të Tij që e praktikojnë Islamin me dashuri dhe që e mbrojnë me një fuqi dhe qëndrueshmëri të madhe! Na bëftë umet të lidhur me dashuri ndaj Resulullahut dhe robër adhurues të devotshëm ndaj Tij!

Na ruajt nga mashtrimi prej kësaj bote e kënaqësive të saj dhe nga humbja e botës tjetër e shpërblimet e saj!

Amin!..

Londër, e xhuma, shtator 1980



KJO PAJISJE

DO TA NDRYSHOJË BOTËN

— Dr. Mustafa Mahmud —

Nga fundi i natës zbulova se kisha kaluar ulur gjithë ditën përpara televizorit. Nuk kisha bërë asgjë, përveç verbimit në ekranin e vogël, i cili më tërhiqte nga një program në tjetrin... nga filmi te kërcimet, këngët, lajmet, ndeshjet e futbollit dhe teatrot.. deri nga mesitë e natës dhe unë shtrirë në shtrat i prangosur me dëshirën time, bile më shumë se prangosje, kam qenë i prangosur pa lëvizur. Gjithashtu, shqisaprangosur dhe i burgosur i vëmendjes në ekranin 22 polesh, duke mos mundur të shkoqitem prej tij.

Në kohën kur programi u mbyll me himnin mbretëror britanik, po fërkoja sytë dhe pyeta veten për ndikimin e kësaj pajisje magjike të çuditshme, e cila i ka përmbysur të gjitha parashikimet.

Tani ndikimi i televizionit të mirë është e kundërta e ndikimit të librit të mirë, sepse libri i mirë e çliron njeriun që e lexon, ndërsa televizioni i mirë e prangos atë, i cili e shikon... ia prangos gjymtyrët, imagjinatën dhe ia lidh duart e këmbët.

Dhe pyeta veten: “A thua këto janë prangosjet

e përzgjedhjes së re, në të cilat vendosen popujt modernë, duke ua shpëlarë trurin me këngë, kërcime, me filma të frikshëm dhe imoralitet, pastaj i mbush me orientimet e kërkuara dhe propagandën e dëshiruar?”

Çfarë lloj brezash të rinj mund të nxjerrin këto universitete televizionike amerikane? Nuk mendoj se ato do të nxjerrin llojin e vjetër të të riut, i cili luftoi dhe ndërtoi perandorizmin. Dhe nuk e mendoj se brezat e rinj në Evropë mund të luftojnë me pasion për çfarëdo çështjeje. I riu i joshur, pas një pune rraskapitëse javore nuk mendon, veçse në një shoqëri argëtuese, krahë të ngrohtë dhe gotë plot, që zhytet në të gjatë fundjavës.

Djali i ri në Evropë punon më zell për të fituar shumë dhe për të shpenzuar shumë.

Ky është ai mentaliteti materialist, i cili udhëheq këtë kohë... nuk të lë ta humbasësh asnjë minutë... merr prej tij maksimumin e asaj që mund t’i japësh duke fituar, shijuar dhe lezetuar... jeto ditët e tua përpara se të shkojnë e të mos kthehen më.

Kjo është ajo filozofia e sotme, për të cilën, i riu jeton me të dhe për të... pas një disku të ri, spektaklit të natës, kërcimeve dhe fustaneve të fundjavës. Filozofi që e përhap, e mbështet dhe e qarkullon pajisja e rrezikshme që quhet televizioni modern.

Pajisje e rrezikshme që do ta ndryshojë gjithë botën... do ta bëjë imoralitetin publik, degjenerimin gjë të zakonshme, pasimin e epshit parësor dhe kërkimin e kënaqësisë të ligjshëm, sikur një kartë furnizimi të nevojshëm.

Në anën socialiste komuniste të botës shohim kontrollin total dhe monizmin partiak që drejton i vetëm në pushtet, të cilin e gjejmë në një censurë të televizionit që ka arritur kulmin e saj në shpëlarjen e trurit dhe boshatisjen e mendjeve, duke i mbushur me dëshirat e udhëheqjes dhe kallëpet e sistemit. Programet, gati të gjitha ecin mbi një urë të varur, prej së cilës nuk shpëton asnjë fjalë.

Ndërkohë, në anën tjetër të botës demokratike të lirë gjejmë pluralizmin partiak, mendimet dhe gazetat e ndryshme, të cilat shfaqin pamje të shumta të kësaj lirie në programet televizive. Teleshikuesi do të shohë përpara tij më shumë se një mendim për ta dëgjuar dhe për ta përzgjedhur. Ai me këtë arratiset nga burgu politik i mendjeve në gjysmën komuniste të botës, por bie në burgun tjetër të epsheve, që nxisin programet e lakuriqësisë dhe imoralitetit të dëshirave të tërbuara që ia bllokojnë (prishin) mendjen.

Ne, në të dy gjendjet jemi përpara një pajisjeje të rrezikshme, e cila ka një aftësi formësuese për mendjen dhe intelektin. Ai (televizioni) me përsëritjen dhe vazhdimësinë, do të krijojë një lloj familjarizimi për ngjyrat e programeve argëtuese, saqë pas kësaj do të jetë i pamundur ndryshimi, apo ndalimi i tyre.

Do të bëhemi përpara njerëzve si fëmija që është familjarizuar me biberonin, apo shishen e qumështit, të cilit kur ia heq nga goja qan dhe bërtet.

Sikur ndonjë reformator popullor të kërkojë ndalimin e këtyre programeve argëtuese, shndërrimin e programeve televizive në lloj universiteti popullor dhe zëvendësimin e medias argëtuese me një media edukuese, shembulli i këtij reformatori do të përballet me kritika e protesta të vetë kësaj mase njerëzish... masa e njerëzve të këngës, puthjeve, serialeve filmike të frikshme, gjakut, seksit dhe futbollit...

Kështu që këto programe na janë bërë tani opium, biberon dhe qumështore, të cilat teleshikuesi i përtyp me kënaqësi, argëtohet me helmin e tyre, flen

nën drogimin e tyre dhe është e pamundur t'ia heqësh prej tij, përveçse me përdorimin e forcës detyruese... e forca detyruese do të na shpjerë në një burg më të keq, ai i censurës mediatike, për të cilin ankohet gjysma e botës komuniste... pra ne ndodhemi mes dy zjarreve. Dilema na çon drejt një rruge të mbyllur.

Kjo pajisje magjike, me mënyrën e saj të krijimit të ndryshimeve në mendjen njerëzore do të jetë, me keqardhje, negative dhe jo pozitive.

Brezat e televizionit të ardhshëm nuk do të jenë më të mirë, bile do të jenë më keq se sa brezat e kohës përpara televizionit.

Televizioni e shton ndikimin e tij te njeriu, duke ditur se ne mund t'i shikojmë programet edhe kur ndodhemi të shtrirë në shtrat në gjendje çlodhjeje të plotë, apo në kolltuk të rehatshëm të veshur me pizhame e përreth nesh fëmijët duke "përpirë" me sytë e tyre çdo lëvizje dhe pëshpëritje. Kjo gjendje e bën njeriun të hapur e të gatshëm për temperimin e çdo ideje që i paraqitet.

Tani kemi filluar të shikojmë fëmijë që kryejnë vepra krimi, vrasjeje e dhune dhe studentë universiteti që familjarizohen me bandat. Me shfaqjen botërisht të tyre përhapen veprat e dhunës, rrëmbimit, pengjeve dhe shpërthimet e bombave... dhe në qytetet e mëdha të Evropës, pothuajse nuk gjen asnjë vajzë, pas të 16-tave, të ruajë virgjërinë e saj.

Në Amerikë, sociologët thonë se këto rezultate janë të natyrshme, sepse i riu amerikan akoma pa arritur në moshën 18-vjeçare, deri atëherë ai ka parë më shumë se 10 mijë krime vrasjeje, përdhunimi, imoraliteti dhe vjedhjeje që kryhen përpara tij në ekranin e televizorit.

Pra, pas gjithë kësaj, çfarë çudie ka që trupi lakuriq të humbë paprekshmërinë e tij, ligji të humbasë prestigjin dhe traditat morale të humbasin mbizotërimin e tyre?

Syri familjarizohet me shthurjen dhe degradimin duke u bërë për shkak të shfaqjes përpara tij një e gjë zakonshme, pa pikë çudie në të... bëhen puthjet, përfaqimet dhe shtrirjet gjëra të zakonshme, sikur dhënia e dorës.

Një e shtypur butoni është bërë garant për të shfaqur gjithë këtë produksion të këtij qytetërimi të çuditshëm me imoralitet, lakuriqësi, art, ideologji, shkencë, të mirën dhe të keqen e saj... vetëm për një sekondë.

Vërtetë që televizioni shfaq në realitet arte të buku-



ra dhe ide botërore. Ai paraqet fenë, virtytet e larta dhe këshilla të mira krahas krimeve, imoralitetit e degradimit, por fesadi (shthurja) vjen në të me shije dhe ngacmim. Ai (fesadi) i këndon shpirtit me dëshirat dhe ia ofron ato në pikën e dobët të tij. Ai i jep një premtim të shpejtë e të menjëhershëm të kënaqësisë, ndërkohë që këshillat fetare paraqesin premtime të mëvonshme dhe jo të shoqëruara me shije artistike dhe zburime poetike, muzikë dhe këngë, të cilat ia drogojnë shqisat. Dhe momentet e fesadit sjellin përpara tyre të gjithë ngacmuesit e bukur... teleshikuesit flenë çdo natë në krahun e kënaqësisë mashtruese të problemit.

Ne jemi përpara një pajisjeje të rrezikshme, që hyn tinëzisht deri edhe në dhomat e gjumit.

Përpara programeve, përsëritjes dhe metodave të caktuara të sjelljeve, të cilat fëmijët dhe të rinjtë i përpijnë dhe qarkullimit nëpër enët e gjakut të tyre të shoqëruara me çaj, kafe dhe cigare, ato shndërrohen në zakone që nuk mund të largohesh prej tyre... pastaj shndërrohen në sjellje... pastaj bëhen natyrë, veçori dhe karakteristikë e kohës.

A jemi ne përpara një pajisjeje që do ta ndryshojë botën?!

Ndonjë mund të përgjigjet se problemi qëndron edhe në vendet, të cilat censuren e televizionit e kanë të rreptë dhe kanë të ndaluar hapjen e kinemave publike... por edhe pse ndalimi, mbikëqyrja dhe

censura ekzistojnë, janë shfaqur fatkeqësi edhe më të rrezikshme, e ato janë video-kasetat kontrabandë, serialet dhe filmat pornografikë që shikohen fshehurazi edhe nëpër shtëpitë e familjet e ndershme. Në ato kasete ka shthurje, ndyrësi e fëlliqësi shumëfish më tepër se sa nëpër kinematë e lejuara. Përmes këtyre video-kasetave kontrabandë ngrihet një tregti botërore e organizuar dhe qendra mafioze seksi të specializuara, që punojnë për përhapjen, regjistrimin dhe qarkullimin e këtyre plaçkave degraduese. Derdhen shuma marramendëse parash për të joshur aktorët me famë kundrejt disa minutave sekuencash seksi të fëlliqura për të ngacmuar oreksin e klientëve dhe tërheqjen e tyre drejt këtij lloji.

Viktimat e tregut të ri të skllavërisë elektronike janë me miliona.

Kështu bëhen të larmishme llojet e joshjes, të cilat u ekspozohen banorëve dhe kush shpëton nga media komuniste majtiste, bie në kurthet e medias fashiste djathtiste. Dhe kush shpëton nga shpëlarja e trurit prej të dyja anëve bie viktimë e mjeteve të informacionit të degjeneruara të sistemit perëndimor demokratik. Dhe kush drejtohet nga vendet konservatore, të cilat ia mbyllin vetes dyert dhe dritaret, ku udhëheqin censurat e ndalimit dhe të mbikëqyrjes nuk janë të sigurt nga hyrja poshtë derës e video-kasetave me filma pornografikë ...

Pas gjithë kësaj, ngrihet tregu i drogës, kokainës,



heroinës, tabletat e ekzazës dhe injeksioni makston foret që përgatit ambientin dhe bën gati klimën.

Tufani i ngacmimeve na çon në epokën e Sodomit e Gomorës së re dhe trazirave, që edhe durimtari qëndron në dilemë përpara tyre.

Pyetësit pyesin: A ka zgjidhje?

Megjithatë... e me gjithë aleatët e zullumit të kësaj kohe, unë e refuzoj dhunën si zgjidhje dhe nuk besoj, veçse në vetëdije, liri, ringjallje të ndërgjegjes dhe debatit të lirë e të hapur dhe hapjes së dritareve për të shikuar të metat, pranimin e mangësive e mjekimin e tyre.

Nuk ka kthim prapa dhe nuk ka refuzim të arritjeve të shkencës.

Televizori, kinemaja dhe radioja janë pajisje neutrale të pafajshme. Janë shenja të përparimit, ndërsa ato bëhen shenja të prapambetjes për shkak të asaj që shfaqet në to.

Zgjidhja është drejtimi i mjeteve të informacionit (medias) nga një tryezë e rumbullakët, ku dialogun në të e udhëheqin njerëzit e urtë të kohës dhe mendimtarët, në përpjekje për të ngritur parime të reja të mbikëqyrjes së vetëdijshme të fjalës së transmetuar.

Ndërsa bandat e seksit dhe të drogës, ato luftohen me mënyrat e tyre.

Pastaj, pas gjithë kësaj mbetet që çdonjëri prej

nesh, së pari të triumfojë në luftë me veten e tij dhe kush humbet luftën me veten e tij, ka humbur në çdo fushë dhe nuk ka ligj, sistem, apo organizatë që e shpëton. Sepse ai ka thyer të gjitha ligjet në kohën që ka ulur armën dhe është dorëzuar përpara epshit në fillim të betejës.

Atëherë, kush mund ta shpëtojë këtë njeri, i cili nuk arriti të shpëtojë veten e tij?

Zoti ynë thotë në Librin e Tij famëlartë, në ajetin më të bukur të tevekkulit (mbështetjes): «**Dhe dijëni se Allahu ndërhyr mes njeriut dhe zemrës së tij dhe se te Ai do të tuboheni** (ringjalleni)». (Enfal, 24)

Kjo është ajo ndërhyrja hyjnore e mëshirshme në momentet e dilemës, ndërkohë që ndonjëri prej nesh ndodhet në pragun e rrënimit të tij. Atëherë vjen vullneti hyjnor e ndërhyr mes ndonjërit prej nesh dhe epshit të zemrës së tij, duke e shpëtuar atë.

Kjo është ajo shpresa, të cilën Allahu e hap për kërkuesit e shpëtimit dhe përgjëruesit, në kohën që të gjitha dyert e tjera janë mbyllur, kur tufani ia ka behur dhe kur urtësia dhe mendja nuk të bëjnë dobi, kur Allahu dëshiron përfundimin e mirë.

Lutuni me mua për një përfundim të mirë.¹

1. (Autori e ka shkruar këtë shkrim dekada më parë. Sikur sot të ishte gjallë, patjetër që do të kishte përmendur edhe teknologjitë e tjera të reja, internetin, telefoninë e lëvizshme etj., të cilat po prangosin për ditë e më tepër njeriun. L.H)



Moda jonë e të gjitha kohërave është **KURANI DHE SUNETI**

— Kubra Çoban —

Faleminderit Zotit që ne jemi myslimanë! Le ta përfaqësojmë sa më mirë këtë emër, me veprat dhe karakterin tonë. Për ta bërë një gjë të tillë, duhet që në çdo moment të ndjekim shembullin e Profetit tonë të dashur, salallahu alejhi ve sellem... Njeriu që nuk jeton ashtu siç beson, fillon të besojë ashtu siç jeton. Aq sa e jetojmë Islamin, aq jemi myslimanë të mirë.

Çfarë mbante Resulullahu në shtëpi? Le ta mendojmë këtë gjë... I Dërguari i Allahut jetoi edhe në varfëri edhe në pasuri. Në shtëpi Ai nuk mbante asgjë të tepërt, vetëm gjërat e domosdoshme. Ai nuk blinte gjëra të reja para se të vjetrat të bëheshin të papërdorshme. Tani le t'u hedhim një sy shtëpive tona... A nuk janë ato një vend i komfortit dhe i luksit?!.. Sipas psikologjisë, suksesi nuk arrihet, në qoftë se nuk hiqet dorë nga rehatia. Sipas Pejgamberit tonë të dashur, kjo botë nuk është asgjë tjetër veçse një vend në të cilin jemi ndalur për të pushuar.

Vajza e Hazreti Omerit dhe gruaja e nderuar e Pejgamberit tonë, Hazreti Hafsa, ka dhënë këtë përgjigje kur e kanë pyetur se si ka pushuar në shtrat Resulullahu (a.s.):

“Ai flinte mbi një mbulesë prej leshi të palosur më dysh. Një natë e palosa mbulesën më katërsh, në mënyrë që të flinte më rehat. Resulullahu (a.s.), kur u zgjua në mëngjes, tha:

“Çfarë keni shtruar si shtrat këtë natë?”

“Ishte dysheku i vjetër, o Resulullah! Unë e palosa më katërsh, në mënyrë që të flini më rehat!..” Pas kësaj, Resulullahu (a.s.), tha:

“Dyshekun tim e dua në formën e tij të vjetër. Rehatia e natës që më dha butësia e dyshekut më pengoi të ngrihem për namazin e natës.” (Tirmidhi, Shemail, 154.)

Nga kjo ngjarje kuptojmë se rehatia nuk sjell probleme vetëm tek ekonomia e njeriut, por edhe tek morali i tij. Kemi shikuar shumë shembuj, në të cilët kjo rehati bëhet shkak për largimin nga Allahu (xh.sh.), dhe nga rruga e drejtë.

Motrat e mia, që i ndërroni perdet, qilimat, kolltukët, sepse atyre u ka ikur moda... Motrat e mia, që blini telefon të ri, sepse i vjetri është shumë i prapambetur... Vëllezërit e mi, që ndërroni makina çdo vit... Motrat e mia, që josheni nga vitrinat e dyqaneve... Nuk po flas për ndjekjen e

Sunetit, por a nuk e kuptoni se, të blesh gjëra të panevojshme, është një shpenzim që nuk duhet bërë? Shpenzimet e tepërta janë të ndaluara në fenë tonë.


Cila duhet të jetë logjika që duhet ndjekur kur jemi duke blerë diçka? A po e blejmë atë send që të na shërbejë neve apo do të jemi ne që do t'i shërbejmë atij?! Ekzistojnë shtëpi të tilla në të cilat marrja e pluhurave zgjat nga mëngjesi deri në darkë. Prej këtij shkakut neve nuk na mbetet kohë as për të përmbushur detyrat tona familjare dhe as ato fetare. Le të mos blejmë gjëra të tepërta, sepse në këtë mënyrë ruajmë edhe kohën dhe nuk e shpenzojmë atë në gjëra të panevojshme, prandaj le të blejmë gjëra të thjeshta e nevojshme. Sigurisht që myslimani duhet të jetë i rregullt dhe i pastër, por ai duhet të zgjedhë një jetë të thjeshtë larg luksit. Myslmani duhet të ndjekë shembullin e Resulullahut (a.s.)... Mënyra e Tij e jetesës është shpjeguar shumë qartë dhe rregullat e Tij janë të përcaktuara. Po jeta jonë, si është?

Le të vijmë tek tema e ngrënies dhe e pirjes... Jemi duke ngrënë në një lokal të shtrenjtë; le të mos flasim për faturën që vjen, por të paktën a shqetësohemi dhe a e pyesim veten se nga vijnë ushqimet?! Sa produkte të dyshimta ka brenda ushqimit? Sa është përqindja e haramit në të? Njeriu që e ka përgatitur ushqimin, me çfarë bote shpirtërore është? Në fund të fundit, ne të gjithë e dimë që njeriu ndikohet nga ushqimet që ha... A nuk duhet të jetë çdo kafshatë e jona hallall, në mënyrë që të fitojmë vetëm të mira prej saj? Një pikë tjetër që ceket në hadith është kjo:

"Sigurisht që ngrënia e çdo gjëje, që dëshiron (për të cilën ke neps), është shpenzim i panevojshëm." (Ibn Maxhe, Etime, 51.)

Le të hamë për të jetuar dhe të mos jetojmë për të ngrënë!.. Gjatë ngrënies qëllimi ynë të jetë fitimi i forcës dhe ruajtja e shëndetit... Për të arritur këtë gjë na mjafton të hamë gjëra hallall dhe pa e tepruar.

Një temë tjetër është edhe ajo e veshjes. Si fillim le të tregojmë mënyrën e duhur të veshjes. Si çdo temë tjetër edhe në këtë pikë duhet të marrim shembull Resulullahun, (a.s.). Ai bënte kujdes që të vishte rroba të pastra dhe të rregullta. Ka transmetime që thonë se Resulullahu ka veshur edhe rroba që kanë pasur shenja, por nuk ka asnjë transmetim që na thotë se Resulullahu ka veshur rroba të papastra!.. Duhet të kemi kujdes që vesh-



jet tona të jenë të gjera dhe të mos na ngjiten për trup. Në këtë mënyrë nuk dalin në pah të gjitha format e trupit. Ky rregull është i vlefshëm si për gratë ashtu edhe për burrat. Nuk ka asnjë rast që Resulullahu të ketë veshur një rrobë të ngjitur për trup. Përveç kësaj, duhet të kujtojmë faktin që pambuku është haram për burrat. Nuk është e pëlqyeshme që gratë të vishen si burrat dhe burrat të vishen si gratë. Nuk duhet të vishemi me rroba të popujve jo myslimanë vetëm nga dëshira për t'u ngjarë atyre. Në vend që ta mbushim dollapin tonë me rroba, le të blejmë disa rroba të pastra dhe të thjeshta dhe t'i veshim ato derisa të vjetrohen. Po, në temën e veshjeve këto janë rregullat që duhen ndjekur.

Mënyra e veshjes e një njeriu na flet për karakterin, shijen dhe stilin e tij. Diçka që i shkon një

njeriu mund të mos i shkoj dikujt tjetër. Një nga gjërat e pakuptimta të modës është fakti që çdo vit, bile çdo stinë disa njerëz vendosin se çfarë duhet veshur. Sa keq më vjen për ata persona që duke u munduar të ndjekin modën veshin çdo lloj modeli dhe çdo ngjyrë, edhe pse nuk duken bukur!.. Njerëzit e zgjuar nuk e ndjekin modën, atë që nganjëherë bën që njerëzit të duken qesharakë. Ata që vendosin për modën e një stine e bëjnë këtë gjë duke u bazuar tek shijet dhe mënyra e tyre e jetesës. Qëllimi i tyre kryesor është që të bëjnë njerëzit të konsumojnë sa më shumë, në mënyrë që vetë të kenë përfitim ekonomik. Sigurisht që të gjithë ne e kemi vënë re se diçka që sot teksa është në modë ka një çmim shumë të lartë, pas disa ditësh çmimi i saj ulet ndjeshëm. Ky ndryshim në çmim është diçka për të cilën njeriu që e paguan do të japë llogari.

Ne duhet të krijojmë një stil i cili të jetë në përputhje me fenë dhe traditën tonë dhe që t'i përshtatet tipit dhe karakterit tonë. Çdo njeri ka veçorinë dhe bukurinë e vet. Syri, vetulla e çdo njeriu është e veçantë prandaj çdo njeri duhet të vishet me gjëra që i pëlqejnë dhe që i shkojnë, pa marrë parasysh se a janë në modë ato apo jo. Gjithashtu, duhet të bëjmë kujdes që të mos bëjmë shpenzime të tepërta. Moda e mbulesës është e njëjta gjë, nuk ka ndryshim nga moda tjetër. Njerëzit që e kanë shpikur këtë e kanë bërë me qëllime përfitimi, sepse sikur ta kishin bërë me qëllime të pastra dhe me dëshirën për t'u shërbyer femrave myslimane, do ta kishin bërë në bazë të rregullave të fesë sonë. Në ditët e sotëm gratë myslimane nganjëherë e kanë të vështirë të gjejnë veshje dhe shami sipas rregullave të Islamit... Ndërkohë që Kurani i urdhëron gratë myslimane t'i fshehin stolitë e tyre, vitrinat e dyqaneve propagandojnë krejt të kundërtën.

Shkurtimisht, mund të themi që duhet të kemi shumë kujdes kur bëjmë zgjedhjet tona. Nuk mund të bëjmë kompromise me rregullat e Allahut vetëm për t'u veshur sipas modës. Jeta jonë duhet të jetë e lidhur me Allahun dhe jo me modën. Moda jonë e të gjitha kohërave është Suneti... Ne duhet të bëjmë atë që thotë Allahu dhe i Dërguari i Tij...

O Zoti ynë! Na bëj neve dhe fëmijët tanë prej njerëzve që nuk janë të fiksuar pas modës dhe luksit. Shëroji të gjitha sëmundjet tona morale! Na bëj neve nga myslimanët me karakter të fortë dhe të qëndrueshëm! Amin!



Jetimi im, i mjeri im...

— Ajshenur Vural —

Sa emër me vlerë është emri “Fatime” për myslimanët. Ai ishte emri i bijës së Pejgamberit, (a.s.) dhe emri i bashkëshortes së Ebu Talibit që u kujdes për të Dërguarin e Allahut (a.s.), pas vdekjes së nënës së Tij, Emine. Ne duhet të diskutojmë shumë rreth kësaj zonje, sepse ajo është një zonjë shembullore për njerëzit në mënyrë që ta kalojnë me sukses një-rën prej sprovave më të mëdha... Ajo i shërbeu një fëmijë jetim, e ushqeu dhe e rriti atë. Këtë e bëri në një mënyrë aq të përsosur sa që kur ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut, alejhissalatu vesselam, hyri në varrin e saj, u shtri aty për një kohë dhe këmishën e tij ja dha asaj për qefin në mënyrë që të mos ndëshkohej në varr... E kujtoi atë gjithmonë me mirësi. Sa fat i madh!..

Edhe sot ka ngjarje që i dëgjoj vazhdimisht dhe që më kujtojnë nënën Fatime... Kam dëgjuar nga vetë jetimët apo nga shumë njerëz që nuk kanë nënë ose nëpërmjet disa të tjerëve se ç’heqin jetimët. Edhe pse shumë zonja që kanë zemër të butë e të mëshirshme prej nëne, tolerancën dhe dhembshurinë që shfaqin ndaj fëmijëve të tyre, nuk mund ta shfaqin ndaj fëmijëve të të tjerëve kur ata ngelin nën përkujdesjen e tyre, nëna Fatime, e sfidoi drejtësinë. Ajo nuk ulej në sofër pa ardhur Pejgamberi dhe nuk i lejonte fëmijët të hanin derisa të vinte Ai. Ajo së pari i jepte Atij për të ngrënë, pastaj fëmijëve të saj...

Në ajetin e 6 të sures Duha, thuhet: “A nuk ishte nevojtar dhe të strehoi?”. Fjala “strehim” që shprehet këtu, nuk është një strehim i rëndomtë... Ka shumë ajete në Kuranin Famëlartë që urdhërojnë mbikëqyrjen e të drejtave të jetimëve duke filluar nga ajetin 8 i sures Insan ku thuhet: “...Kujdesen për jetimin.”

Qendra e energjisë së zemrës sime, burimi i shëndetit thotë:

“Të kujdesesh për jetimin nuk do të thotë t’i blesh dy palë rroba për Bajram. Do të thotë t’i heqësh barrën, rëndesën e problemeve të tij psikologjike...” Kjo gjendje në popull ka zënë vendi duke u shprehur në këtë mënyrë “Jetimi u dhimbset shumë njerëzve, por janë të paktë ata që e ushqejnë.”

O Allah, falu mëshirë atyre që kanë nën përkujdesje jetimë!

Fal mëshirë në zemrat e tyre në mënyrë që të kujdesen për jetimët dhe Emineve e Abdullahëve të mos u ngelet koka pas...

Bëji ata të mëshirshëm, zgjerojua të ardhurat që të mos ju vijë rëndë gjendja e jetimëve, t’u duken të këndshëm dhe t’u pëlqejnë...

Lësho mëshirë rreth tyre që fjalët përreth të mos ua rëndojnë barrën, por përkundrazi t’u lehtësohet...

Jetimi i Amine... Kur po i vdiste nëna, ai i qëndronte te koka. Sa tablo e paharrueshme dhe e dhimbshme që është kjo për një fëmijë gjashtë vjeç!.. Ç’dramë e madhe!. Sa gjendje të vështirë përjetojnë dhe do të përjetojnë jetimët çfarëdo moshe qofshin deri në Kiamet!

Poeti thotë: “A ju ka vdekur juve babai? Mua më vdiq dhe u verbova.”

Kushedi sa vjeç ishte, por mesa duket ishte burrë i madh... Sado që të jetë, kur vdesin prindërit fëmija ngel jetim... Ka edhe shembuj këndshëm siç është ky:

Një mikeshë tregon se kur i vdiq nëna e burrit, ajo e tregohet e mëshirshme ndaj tij duke thënë me respekt ndaj Pejgamberit (a.s.) “Tashmë u bëre si Ai...”

Anadulli është vendi i grave të kulturuar, qofshin ato të ditshme ose jo... Çfarë perlash fshihen në kraharorin e saj... Në një-rën anë jetimët të cilëve u plaçkitet prona e pasuria, vajza që shtypen në punë të rënda ndërkohë që djemtë rrinë, në anën tjetër ka gjyshër fisnikë si Abdulmuttalibi, zonja si Fatma dhe xhaxhallarë si Ebu Talibi të cilët sillen më të mëshirshëm me ta duke thënë “Është jetim dhe e ka zemrën të brishtë”, që u bëjnë mirësi më shumë se fëmijëve të tyre...

O Zot, lehtësojua sprovën dhe qetësojua zemrat!.. Ti je streha dhe mbështetja e vetme për jetimët të cilët shtypen ngaqë nuk kanë njerëz që përkujdesen për ta...

O Zot që në ditën e gjykimit do të marrësh në llogari secilin prej nesh, mëshiroji jetimët dhe ata të cilët përkujdesen për ta... Amin



Një zonjë prej BANORËVE TË XHENETIT

— Adem Saraç —

Një ditë prej ditëve të bukura të jetës plot siharique të Pejgamberit (a.s.)...

Një ditë që do ta bënte Ummu Ejmen Bereken të fluturonte nga gëzimi...

Njëra prej zonjave sahabe fatlume, e cila me moralin e saj të bukur, kishte hapur derën ndaj një bote të re, e bëri rrugën me hapa të shpejtë dhe shkoi në shtëpinë e Ummu Ejmenit. Fryma po i merrej. Gjendja e saj e shqetësoi Ummu Ejmenin! Edhe pse po merrte frymë me vështirësi prej lodhjes, menjëherë i tha:

-O Ummu Ejmen! A e di çfarë ka thënë i Dërguari i Allahut?

-Nga ta di nëse nuk ma thua! Por ji e sigurt se çfarëdo që të ketë thënë, patjetër është e vërtetë. Për këtë nuk kam aspak dyshim!

“Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!”¹

Ummu Ejmeni u hodh nga vendi me një lëvizje të pavetëdijshme sikur të kishte pësuar një goditje në zemër! U zverdh në fytyrë dhe i ndryshoi ngjyra! Mezi arriti të fliste.

-A e kupton se çfarë thua?

-Unë të tregova atë që tha i Dërguari i Allahut, (a.s.), për ty!

-Pse u zverdhe kaq shumë?

-Me të vërtetë ka thënë ashtu i Dërguari i Allahut, (a.s.)?

-Unë të tregova vetëm ato që tha! Ne e dimë të gjithë se ti nuk mendon të martohesh.

-Nuk është kjo që më tronditi mua, fqinje!

-Çfarë të tronditi atëherë?

-Fjala e Tij!

-Edhe unë prandaj erdha tek ti, që të të lajmëroja! Çdo fjalë e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është e vlefshme për ne! Por këtë fjalë e tha veçanërisht për ty! Unë u gëzova shumë për ty dhe desha ta sillja lajmin menjëherë!

-Ma thuaj edhe një herë atë që tha!

-Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!

Ummu Ejmeni u përkeqësua përsëri. Pothuajse do t'i binte të fikët. Mezi e mblodhi veten, u ngrit dhe iu drejtua fqinjës së saj:

-A me të vërtetë ka thënë kështu? A kështu ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.)?

1. Ibn Is'hak, Siretu Ibn Is'hak el-Musemma bi Kitabi'l Mubtede' ve'l-Meb'as ve'l-Megazi; fq. 385; Ibn Hisham, es-Siretu'n-Nebevijje, vëll. 2, fq. 342



-Çfarë po të ndodh, Ummu Ejmen?

-A mund ta përsëritësh edhe një herë? A mund ta përsëritësh edhe një herë atë fjalë të pashoqe?

-Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!

-Aman o Zot!

Ummu Ejmeni po lëkundej si një rrap i madh majtas e djathtas. Sapo do të rrëzohej, e kapi fqinjja e saj...

-Çfarë ke për hir të Zotit? Nëse nuk dëshiron të martohesh, mos u marto Ummu Ejmen! I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk të detyron për këtë.

-Për fat të keq, çështja nuk është martesë, fqinje! Mua më tronditën fjalët mahnitëse të Tij!

-Si?

-Përgëzimi “grua prej banorëve të Xhenetit” që ka thënë për mua!

-Si nuk e kuptova unë këtë! Edhe pse të njoftova për këtë përgëzim! I Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilëson si “grua prej banorëve të Xhenetit”.

-Me të vërtetë, a je e sigurt se ka thënë kështu?

-Jo vetëm unë, por të gjithë që gjendeshin aty e dëgjuan këtë. Pas pak do të vijnë edhe ata për të të përgëzuar.

-“Grua prej banorëve të Xhenetit!” Aman o Zot! Sa larg jam unë dhe sa larg është të qenët grua prej banorëve të Xhenetit!

-Por i Dërguari i Allahut, (a.s.), ashtu tha!

-Nëse Ai ka thënë, ka thënë të vërtetën, por unë nuk e meritoj këtë!

-A e di më mirë ti se Ai, o Ummu Ejmen?

-Estagfirullah! Me mijëra herë estagfirullah! Sigurisht se Ai (a.s.), e di më mirë.²

Ummu Ejmeni u ul në vendin ku ishte dhe filloi të qante. Nga ana tjetër qante me dënese: “Grua prej banorëve të Xhenetit, ë? Grua prej banorëve të Xhenetit? Po qante aq shumë, saqë fqinja e saj s’po e qetësonte dot.

Fqinja e saj e pa se kjo qarje me dënese ishte nga gëzimi i përgëzimit “grua prej banorëve të Xhenetit” dhe nuk ndërhyri më. Madje, nuk rezistoi dot dhe filloi të qante bashkë me të.

Si të mos qante? A nuk qahet për një gëzim të tillë?

Ndërkohë erdhën edhe gratë e tjera. Edhe ato sollën të njëjtin përgëzim. Ato e përgëzonin dhe e uronin këtë zonjë të bekuar.

Ummu Ejmeni (r.a.), e cila dëshmoi çdo gjë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që nga lindja e derisa ndërroi jetë, kishte një zemër shumë të ndjeshme dhe të butë. Ajo e donte të Dërguarin e Allahut (a.s.), më shumë se veten e saj.

Ummu Ejmeni jetonte çdo çast me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në çdo gjë reflektonte Atë dhe e gjithë jeta e saj pothuajse ishte e veshur me Atë (a.s.). Ajo e donte aq shumë Pejgamberin (a.s.), saqë një ditë Ai tha: “Ajo ishte nëna ime pas nënës sime.”

Ummu Ejmeni e kishte përqafuar Islamin me të gjithë qenien e saj dhe që në këtë botë, u bë prej të përgëzuarve me Xhenet.

Lum për ata që janë përgëzuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.)!

2. Ibn Haxher el-Askalani, el-Isabe fi Temjizi’s-Sahabe, 11849; M - hammed Raci Hasen Kennas, Rasûlullah’in Etrafındaki Hanım Sahâbiler, fq. 71



FRUTAT DHE PERIMET E KUQE

PËR ZEMRËN, GJAKUN DHE TRURIN

Frutat dhe perimet me ngjyrë të kuqe janë të ngrohta dhe të shëndetshme për zemrën.

Më poshtë do të zbuloni arsyet përse perimet dhe frutat e kuqe rekomandohen të jenë pjesë e një regjimi të shëndetshëm ushqimor.

SHEGËT

Shegët përmbajnë vitaminë K, e rëndësishme për koagulimin e gjakut.

Ato janë të pasura me fibër dhe vitaminë C.

Ngjyra e kuqe e tyre vjen nga flavonoidët që kanë një ndikim të fortë në uljen e rrezikut nga sëmundjet koronare.

Shegët janë të dobishme edhe kundër qelizave kancerogjene dhe inflamacionit.

Konsumimi i shegës ul mundësinë e lindjeve të parakohshme por edhe shanset për zhvillimin e sëmundjes së Alzheimerit mes njerëzve të moshuar.

Ajo ndihmon të mbajë nën kontroll problemet e moshës siç janë rrudhat dhe u jep njerëzve një lëkurë mjaft rinore plot shkëlqim.

Për më tepër, shega ndihmon femrat të kapërcejnë simptomat e depresionit gjatë menstruacioneve ose pas menopauzës.

Shegët mund t'i hani veçmas, ose t'i konsumoni bashkë me sallata, mish ose peshk.

BORONICA E KUQE

Ky frut pylli e merr ngjyrën e kuqe nga një substancë mirëbërëse e njohur si anthocianina.

Lëngu i boronicës së kuqe parandalon dhe trajton infeksionet urinare.

Kokrrat e kuqe janë një burim i shkëlqyer i vitaminës C dhe manganit.

Fibra që gjendet tek boronica e kuqe është një tjetër vlerë e shtuar, sepse tek çdo racion me këto kokrra të shijshme ne gjejmë 20 % të dozës së rekomanduar ditore të fibrës.

Një racion me boronica të kuqe jep edhe 24% të dozës ditore të vitaminës C dhe vitaminës E.

Në variantin e thatë, boronicat e kuqe mund të përfshihen në sallata dhe antipasta.

PANXHARI

Panxhari është perimja e nëntokës më e kuqe që ekziston.

Panxhari është një burim i shkëlqyer i manganit, folatit, fibrës dhe vitaminës C.

Kjo perime përmban edhe kalium që ul tensionin e gjakut.

Ngjyra e kuqe vjen nga antioksidantët e shumtë që ka panxhari.

Perimja popullore përmban betainë, që mbron qelizat nga stresi.

Substancat e tjera zgjerojnë enët e gjakut dhe përmirësojnë furnizimin me oksigjen.

Panxharin zgjidhni gjithnjë kokërr vogël me një lëkurë të lëmuar.

Atë mund ta zieni, piqni ose të kavërdisni.

Panxharin duhet ta shoqëroni gjithmonë me vaj ulliri.



FARË E ZEZË DHE MJALTË, TONIKU I FUQISHËM PËR IMUNITETIN

Fara e zezë (*Nigella Sativa*) është bimë që formon një kapsulë frutore e cila është përdorur në mjekësinë popullore prej 2000 vitesh.

Ajo është zbuluar për herë të parë në varrin e Tutankhamunit faraonit më të famshëm të Egjiptit.

Fara e zezë është përdorur që herët kundër dhimbjeve të kokës, dhëmbit, bllokimeve të rrugëve të frymëmarrjes, astmës, artitit, infeksioneve dhe pranisë së parazitëve në sistemin tretës.

Në ditët e sotme, pavarësisht mungesës së provave bindëse shkencore, fara e zezë përdoret edhe kundër diabetit, tensionit të lartë të gjakut dhe mbi-peshës.

Ajo njihet jo vetëm si fara e zezë por edhe nigella, qimnoni i zi, kalonji e të tjera.

Farat përdoren si erëz në kuzhinën e Lindjes së Mesme dhe të Indisë.

Shija e tyre është e athët, e fortë dhe aromatike.

Në fenë Islame, vlerat e farës së zezë përshkruhen si të mrekullueshme nënvizuar edhe nga Profeti

Muhamed a.s.14 shekuj më parë: “Te fara e zezë ka shërim për çdo sëmundje përveç vdekjes.”

Një studim i vitit 2014 nga Universiteti i Salzburgut në Austri ofroi dokumenta që provonin se fara e zezë kishte efekt kundër inflamacionit dhe ishte e pasur me antioksidantë.

Pavarësisht mungesës së të dhënave, në rrjetet sociale u përhap me vrull pretendimi se hidroksil-klorina është e prejardhur nga fara e zezë.

SI KONSUMOHET FARA E ZEZË?

Mënyrat e konsumit të farës së zezë janë të ndryshme dhe shpesh si pjesë e trajtimeve bimore.

Ajo mund të gëlltitet, të shtypet e të bëhet pluhur duke u përzier me ujë, mjaltë ose vaj, të zihet si çaj ose të transformohet në vaj esencial për aplikim në lëkurë.

Mënyra më e këshilluar në mjekësinë bimore është përzierja me mjaltin sepse besohet se dyfishon sasinë e antoksidantëve dhe formon një tonik shumë të shëndetshëm.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Logja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër
+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË

“Urdhëroji njerëzit e tu
të falin namazin
dhe ji i vazhdueshëm
edhe vetë në të.
Ne nuk kërkojmë
furnizim prej teje,
Ne jemi ata
që të furnizojmë ty.”

(TaHa, 132)

